

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5788
E martë, 28 maj 2019
çmimi 0.40 €

Wilson: ShBA-ja do të jetë gjithmonë partnere e fuqishme e Kosovës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

JANË PUBLIKUAR REZULTATET PRELIMINARE TË ZGJEDHJEVE PËR PARLAMENTIN EVROPIAN NË 28 SHTETET ANËTARE TË BE-së

FAQE 4-5

Partitë pro BE-së fitojnë shumicën në Parlamentin Evropian

- Rezultatet e zgjedhjeve në BE nuk e rrezikojnë projektin e zgjerimit

Për herë të parë që prej mbajtjes së zgjedhjeve evropiane në vitin 1979, partitë e qendrës kanë humbur shumicën në Parlamentin Evropian. Sipas rezultateve preliminare të këtyre zgjedhjeve, dy forcat tradicionale, Partia Popullore Evropiane dhe Aleanca e Socialistëve dhe Demokratëve, kanë fituar 44.21 për qind të votës së përgjithshme, që shënon rënie nga 54 për qind në vitin 2014. Megjithatë, sipas këtyre rezultateve,



forca progresive pro-BE (EPP, S&D, ALDE+En Marche, GREENS-EFA) do të mbetet forca më e madhe politike e BE-së, me 67.37 për qind të votës së përgjithshme

OPINION

KUR 'BURDUSHI' I CAKTON MENYNË USHQIMORE DEPUTETIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS!

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE

MALI I ZI I OFRON PËRKRAHJE KOSOVËS NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

MINISTRI ISMAILI NËNSHKRUAN UDHËZIMIN ADMINISTRATIV QË UL ÇMIMET E BARNAVE

EKONOMI

PSE DUHET TË JENË TË ARDHURAT DERI NË 300 EURO NË MUAJ?

Ramiz KELMENDI



DOGANA KALON 400 MILIONË EURO TË HYRA PËR BUXHETIN E KOSOVËS

F. 10

KULTURË

INTERKOMUNIKIMI NË RELIKTE KOHËSH

Nexhat REXHA

SPORT

PREKAZI: PËR KOSOVËN JAPIM MAKSIMUMIN

F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", AURORA BERISHA

FAQE 7

Sfidë kryesore në Drenas mbetet ndalimi i ndërtimeve pa leje

Drejtoresha e Inspeksionit në Komunën e Drenasit, Aurora Berisha, ka bërë me dije se ndalimi i ndërtimeve pa leje në këtë komunë mbetet sfida kryesore e këtij sektori. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se inspeksioni në këtë komunë realizon inspektime të rregullta në terren duke parandaluar

zhvillimin e ndërtimeve pa leje dhe duke u kërkuar investitorëve që t'i respektojnë procedurat e aplikimit të lejes. Në këtë intervistë Berisha ka treguar edhe për sfidat që ka hasur në punën e përditshme. Ajo ka vlerësuar se mbështetja politike që kryetari Ramiz Lladrovci i jep asaj dhe gjashtë drejtoreshave të tjera ua ka lehtësuar shumë punën

Thaçi inkurajon Kuvendin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë ta nxjerrin deklaratën e bashkimit

FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Protesta e opozitës, më 2 qershor

TIRANË, 27 MAJ - Fronti opozitar ka vendosur që protesta kombëtare të zhvillohet të dielën, më 2 qershor. Të shtunën kërret e opozitës vendosën që protesta të mbahej më 31 maj. Shtyrja e protestës është propozuar nga drejtues të opozitës për t'i respektuar besimtarët myslimanë në vend, pasi data 31 është Nata e Kadrit.

Burime nga opozita bënë me dije se "protesta kombëtare do të mbahet më 2 qershor, në orën 19.00, përpara Kryeministrit". Ndërkohë më 1 qershor Partia Socialiste ka njoftuar se do ta mbajë meetingun hapës të fushatës elektorale për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Burime nga opozita thanë se data

1 qershor u shmang për protestën, pasi këtë ditë është Festa e Fëmijëve. Pas protestës së të shtunës së kaluar, tubimi i radhës pritet të jetë edhe më masiv. Opozita kërkon largimin e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e një qeverie transitore që do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme.



Thaçi inkurajon Kuvendin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë ta nxjerrin deklaratën e bashkimit

"E ardhmja jonë e sigurt është në NATO dhe në Bashkimin Evropian, por po krijohen rrethana të reja që zgjidhja më e mirë do të ishte që dy kuvendet, ai i Kosovës dhe ai i Shqipërisë, t'i nxjerrin deklaratat e nevojshme, të vullnetit të popullit të Kosovës dhe të Shqipërisë, që të jetojmë në një shtet të përbashkët, pa kufij", ka thënë presidenti Thaçi



të Shqipërisë, që të jetojmë në një shtet të përbashkët, pa kufij", ka thënë Thaçi të hënën në shënimin e njëzetvjetorit të operacionit

"Shigjeta DO-2" dhe luftimeve në Pashtrik. Ai ka thënë se beteja e Pashtrikut ishte një prej betejave më të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Projekti 'Shigjeta' me organizimin, me vendimmarrjen, me jehonën e brendshme dhe ndërkombëtare, ishte kryeprojekti i betejave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti i vendit ka thënë se domosdoshmëria e një fronti të gjerë dhe masiv luftarak të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përballë Ushtrisë dhe Policisë serbe ishte shtruar qysh në janar të vitit 1999. "Populli ynë sapo kishte përjetuar një prej masakrave më çnjerëzore në Reçak, por për të mos lejuar që të ndodhnin edhe më tutje, në atë kohë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së e kishte ngarkuar Drejtorinë Operative për ta përgatitur operacionin ushtarak 'Shigjeta', i cili rezultoi të jetë operacioni më i madh, më masiv

dhe më frontal i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, të gjithë ju bashkëluftëtarë, veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidë të luftës, të gjithë ju pjesëmarrës të këtij fronti të gjerë luftarak, çdoherë ndjehuni krenarë për lavdinë e betejës që e keni zhvilluar dhe që e keni fituar bashkë me aleatët", është shprehur Thaçi.

Ai ka theksuar se në atë kohë si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme e kujton më së miri jo vetëm jehonën në rrafshin e brendshëm të këtij fronti të gjerë ushtarak, por edhe jehonën ndërkombëtare gjithëbotërore që kishte fillimi i operacionit "Shigjeta", i cili, përveç depërtimit në atë kohë në tri drejtime operative, përkatësisht në drejtim të Koshares, të Pashtrikut dhe Koretnikut, kishte për qëllim edhe koordinimin me forcat ajrore të NATO-s, të cilat pandërprerë godisnin vendqendrimet e kamufluara të Policisë dhe Ushtrisë serbe.

Presidenti Thaçi ka theksuar se fronti i Pashtrikut ishte front i shpresës, i besimit, i optimizmit, ishte fronti i fitores përfundimtare historike të shqiptarëve kundër Serbisë. Duke u mbështetur në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, të gjithë dëshmorët e rënë në betejën e Pashtrikut, presidenti Thaçi i ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës".

PASHTRIK, 27 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se po krijohen edhe rrethanat e reja, të cilat, sipas tij, ofrojnë bashkimin e Kosovës dhe të Shqipërisë si zgjidhjen më të mirë. "E ardhmja jonë e sigurt është në

NATO dhe në Bashkimin Evropian, por po krijohen rrethana të reja që zgjidhja më e mirë do të ishte që dy kuvendet, ai i Kosovës dhe ai i Shqipërisë, t'i nxjerrin deklaratat e nevojshme, të vullnetit të popullit të Kosovës dhe



Kryeministri Zaev ndryshon qeverinë

SHKUP, 27 MAJ - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka paralajmëruar ndërrimin e më shumë se një të tretën e ministrave të kabinetit qeveritar, që do ta nënkuptonte nevojën për votimin e gjithë qeverisë në Kuvend. Njoftimi erdhi pas mbledhjes së Këshillit Qendror të partisë së tij Social-Demokrate, në të cilën u shkarkuan nga detyra të gjithë gjashtë nënkryetarët e partisë dhe organet e tjera partiake.

"Unë jam afër ndërrimit të një të tretës së ministrave, që nënkupton se do të kemi votim për gjithë qeverinë. Do të ketë ndryshime edhe në pozicionet e tjera në qeveri. Gjithkund ku është regjistruar arrogancë dhe mungesë e rezultateve do të ketë ndryshime. Do ta përcjell punën e çdo zyrtari, do të kritikoj dhe kërkoj dorëheqjen e secilit që nuk punon", tha Zaevi. Kryeministri Zaev ndryshime pret edhe te fushat që drejtohen

nga Bashkimi Demokratik për Integrim. Siç bëhet me dije, Zaevi i ka dorëzuar kreut të BDI-së, Ali Ahmeti, një listë me emrat e zyrtarëve të kësaj partie që duhet ndryshuar për shkak të rezultateve të dobëta.

Ndryshimet në qeveri dhe parti, Zaevi i paralajmëroi që pas zgjedhjeve presidenciale, i pakënaqur nga rezultati, veçanërisht në raundin e parë, kur partia e tij LSDM, në koalicion me 31 parti, arriti fitoren me vetëm rreth 5



mijë vota dallim kundrejt VMRO-DPMNE që në zgjedhje mori pjesë e vetme.

Ndryshimet në qeveri pritet të ndodhin në fillim të muajit qershor.

Zëvendës-presidenti i Këshillit Atlantik, Damon Wilson, së bashku me një delegacion nga Senati dhe Kongresi Amerikan kanë vizituar Kosovën

Wilson: ShBA-ja do të jetë gjithmonë partnere e fuqishme e Kosovës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do të jenë gjithmonë partnere e fuqishme e shtetit të Kosovës në procese jetike. Kështu ka deklaruar të hënën në Prishtinë zëvendës-presidenti i Këshillit Atlantik, Damon Wilson, gjatë takimeve të ndara me liderët shtetërorë të Kosovës. Ai ka thënë se Këshilli Atlantik do të angazhohet edhe më shumë brenda ShBA-së për ta shtuar vëmendjen dhe mbështetjen ndaj Kosovës. Wilson është zotuar se Amerika do ta ndihmojë Kosovën në ofrimin e ekspertizës më të mirë për të asistuar në procesin e dialogut me Serbinë



këtë proces. Miqtë nga Këshilli i Atlantikut i falënderova për kontributin e deritanishëm dhe u kërkova mbështetje në fushën e informimit të publikut dhe planifikimit strategjik. Gjithashtu, i informova për nismën time në kuadër të drejtësisë tranzicionale duke shpjeguar se zbardhja e së kaluarës dhe vënia në vend e drejtësisë për krimet e kryera nga shteti serb i shërben përfundimit të konfliktit dhe pajtimit ndëretnik", ka deklaruar Veseli.

Edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim delegacionin amerikan të drejtuar nga zëvendës-presidenti ekzekutiv i Këshillit Atlantik, Damon Wilson. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, duke kujtuar raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka vlerësuar se Amerika është marrëdhënia më e rëndësishme e Kosovës. "Jam i nderuar që ju kemi për vizitë në Kosovë. Ne jemi përgjithmonë mirënjohës dhe në linjë me Amerikën dhe shërbejmë si aleati dhe mik i madh i Amerikës në Ballkan", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Kosova ndan botëkuptimin e Amerikës në të gjitha çështjet kryesore.

Ai ka treguar se Kosova ka bashkëpunim me ShBA-në në të gjitha fushat e sigurisë dhe ekonomisë. Kurse sa i përket dialogut me Serbinë, kryeministri Haradinaj ka theksuar se Kosova është e gatshme për një marrëveshje përfundimtare në kufijtë ekzistues. Ai ka thënë se shkëmbimet e territoreve çojnë në luftëra të reja dhe zgjojnë tensione në rajon. "Ne jemi të gatshëm të bëjmë një marrëveshje finale, ligjrisht të obligueshme në kufijtë ekzistues dhe të mos kemi parakushte", është shprehur Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka njoftuar delegacionin me të arriturat e vendit në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit, reformave të përgjithshme dhe përparimin në fuqizimin e ekonomisë së vendit.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 MAJ - Zëvendës-presidenti i Këshillit Atlantik, Damon Wilson, së bashku me një delegacion nga Senati dhe Kongresi Amerikan, të hënën kanë qëndruar për vizitë në Kosovë. Delegacioni amerikan është pritur në takime të ndara nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Me këtë rast, zyrtari amerikan Damon Wilson ka bërë me dije se Këshilli Atlantik do të angazhohet edhe më shumë brenda ShBA-së për ta shtuar vëmendjen dhe mbështetjen ndaj Kosovës. Ai është zotuar se Amerika do ta ndihmojë Kosovën për ofrimin e ekspertizës më të mirë për të asistuar në procesin e dialogut me Serbinë. Damon Wilson ka thënë se

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do të jenë gjithmonë partnere e fuqishme e shtetit të Kosovës. Presidenti Hashim Thaçi e ka falënderuar zëvendës-presidentin Wilson për kontributin e vazhdueshëm të Këshillit Atlantik në Kosovë për forcimin e strukturave të sigurisë. "Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, populli dhe shteti i Kosovës janë mirënjohës përjetësisht për rolin përcaktues të ShBA-së në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë ai. Ai dhe zyrtarët amerikanë kanë biseduar edhe për procesin e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës fillimisht në Partneritetin për Paqe, më pas edhe në NATO.

Po në këtë takim është biseduar edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe domosdoshmërinë e shfrytëzimit të momentumit për arritjen e një

marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht obliguese. "Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të ketë pasoja për sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe u hapë rrugë elementeve antievropiane", është shprehur Thaçi.

Presidenti Thaçi ka thënë se bashkë me ShBA-në do ta vazhdojnë angazhimin maksimal për të ruajtur dhe zhvilluar paqen e sigurinë në Kosovë dhe rajon.

Delegacioni amerikan, i kryesuar nga zëvendës-presidenti i Këshillit Atlantik, Damon Wilson, është pritur në takim edhe nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli.

Kryeparlamentari Veseli dhe zëvendës-presidenti Wilson kanë diskutuar për bashkëpunimin midis Kosovës dhe ShBA-së si dhe për zhvillimet politike në vend dhe rajon.

Veseli ka rikonfirmuar mirënjohjen e thellë të Kosovës e të popullit të saj për gjithë mbështetjen që shteti amerikan i ka dhënë dhe po jep për vendin tonë në të gjitha fushat. Ai ka thënë se është i domosdoshëm vazhdimi i mbështetjes amerikane për Kosovën edhe në sfidat e tjera që ajo ka para vetes si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe të konsolidimit të mëtejshëm të shtetësisë në rrafshin ndërkombehtar. "Me përfaqësuesit e Këshillit Atlantik dhe të administratës së Kongresit Amerikan pata një diskutim përmbajtësor për Kosovën dhe zhvillimet rajonale. U fokusua me dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku theksova vendosmërinë tonë për t'u përpjekur në arritjen e një marrëveshjeje ligjore gjithëpërfshirëse që siguron njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, BE dhe NATO. Për ta bërë këtë gjë, presim që ShBA-ja të luajë një rol më aktiv për ta mbështetur



Veseli kërkon hetime të plota për aferën 'Spitali'

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka kërkuar llogari nga organet e drejtësisë për zbardhjen e aferës 'Spitali'. Ai ka thënë se i gjithë procesi që nga fillimi e deri në fund duhet të hetohet dhe të ketë transparencë të plotë. "Ajo që tashmë është kuptuar botërisht,

është fakti se krejt skema e mashtrimit në videoincizimet e publikuar ndërlidhet me ndërtime dhe licencimin e një spitali privat. Dhe ende deri tash, në opinionin publik nuk është sqaruar rrjedha e licencimit të këtij spitali që ka ndodhur në vitin 2015 dhe për të cilin dyshohet se është pasojë e një skeme të korrupsionit institucional. Duke e kon-

sideruar tepër të rëndësishme zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje, kërkoj urgjentisht nga organet përgjegjëse të rendit dhe të ligjit që t'i kryejnë detyrat e tyre me profesionalizëm, përgjegjësi dhe transparencë të plotë për hetimin dhe ndjekjen e të gjithë personave përgjegjës dhe të dyshuar për këtë aferë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



Janë publikuar rezultatet preliminare të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian në 28 shtetet anëtare të BE-së

Partitë pro BE-së fitojnë shumicë

- Rezultatet e zgjedhjeve në BE nuk e rrezikojnë projektin e zgjerimit

Për herë të parë që prej mbajtjes së zgjedhjeve evropiane në vitin 1979, partitë e qendrës kanë humbur shumicën në Parlamentin Evropian. Sipas rezultateve preliminare të këtyre zgjedhjeve, dy forcat tradicionale, Partia Popullore Evropiane dhe Aleanca e Socialistëve dhe Demokratëve, kanë fituar 44.21 për qind të votës së përgjithshme, që shënon rënie nga 54 për qind në vitin 2014. Megjithatë, sipas këtyre rezultateve, forca progresive pro-BE (EPP, S&D, ALDE+En Marche, GREENS-EFA) do të mbetet forca më e madhe politike e BE-së, me 67.37 për qind të votës së përgjithshme



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 MAJ - Partitë politike pro BE-së do të mbesin forcat më të mëdha politike në Parlamentin Evropian, me 67.37 për qind të votave, ndonëse grupimet e mëdha të qendrës së djathtë dhe asaj të majtë e kanë humbur shumicën e tyre të kombinuar në zgjedhjet e 23-26 majit. Sipas rezultateve preliminare të këtyre zgjedhjeve, dy forcat tradicionale, Partia Popullore Evropiane dhe Aleanca e Socialistëve dhe Demokratëve kanë fituar 44.21 për qind të votës së përgjithshme, që shënon rënie nga 54 për qind në vitin 2014. Për ta siguruar vendimmarrjen këtyre dy grupeve u nevojitet koalicioni me Liberal Demokratët ose me të Gjellbrit, të cilët kanë qenë surpriza e këtyre zgjedhjeve. Në total forca progresive pro-BE

(EPP, S&D, ALDE+En Marche, GREENS-EFA) ka fituar 67.37 për qind të votës së përgjithshme. Ndërsa partitë konservatore dhe populiste (Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF), ECR, GUE / NGL, 5STAR + BREXIT (ish-EFDD), Non-Inscrits) kanë arritur të fitojnë 28.89 për qind të votës së përgjithshme. Partitë politike të tjera kanë fituar 3.73 për qind të votës.

Në këto zgjedhje rritje të madhe kanë shënuar grupi Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE) + En Marche e presidentit Macron, e cila është rritur për 38 deputetë, nga 69 (2014) në 107 (2019) deputetë. Pastaj, Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF), e udhëhequr nga Matteo Salvini, është rritur për 22 deputetë, nga 36 (2014) në 58 (2019) deputetë. Ndërsa Të Gjellbër/Aleanca e Lirë

Evropiane (Greens-EFA) është rritur për 18 deputetë, nga 52 (2014) në 70 (2019) deputetë.

E papritura më e madhe e zgjedhjeve evropiane ishte pjesëmarrja e lartë në votime. Rreth 51 për qind e 420 milionë votuesve në vendet e BE-së kanë hedhur votën në kutitë e votimeve. Pjesëmarrja në votime kësaj here ishte tetë për qind më e lartë se në zgjedhjet e fundit mbajtur pesë vjet më parë. Protestat kundër politikës së klimës, nxënësit në greva dhe rezistenca e partive populiste të djathta që janë kundër BE-së, duket se i kanë mobilizuar njerëzit për të dalë në zgjedhje.

Progresistët nuk do të bashkëpunojnë me partitë që janë kundër BE-së

Përfaqësuesit e partive pro-evropiane kanë thënë të hënën se nuk do të bashkëpunojnë me partitë që janë kundër Bashkimit Evropian. Të dy grupet e mëdha politike, Partia Popullore Evropiane, po dhe Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve, kanë bërë thirrje për koalicion në mes të partive pro-evropiane. Lideri i grupit të qendrës së djathtë, Partia Popullore Evropiane, Manfred Weber, ka thënë se ata që dëshirojnë të ketë Bashkim Evropian të fortë duhet t'i bashkojnë forcat. Weber ka thënë se grupi i tij nuk do të bashkëpunojë me asnjë parti që nuk beson në të ardhmen e Bashkimit Evropian. Kurse lideri i Partisë së Socialistëve dhe Demokratëve,

Kush ku ka fituar?

Në bazë të rezultateve preliminare këto janë shtetet anëtare të BE-së ku kanë fituar grupet politike respektive: EPP ka fituar në 13 shtete anëtare: Austria, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Finlanda, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Letonia, Lituania, Sllovakia, Sllovenia. S&D ka fituar në 7 shtete anëtare: Danimarkë, Maltë, Holandë, Portugali, Romani, Spanjë, Suedi.

ALDE + EN MARCHE ka fituar në 3 shtete anëtare: Çeki, Estoni, Luksemburg.

Aleanca Evropiane e Popujve dhe Kombeve (ish-ENF) ka fituar në 2 shtete anëtare: Francë, Itali. ECR ka fituar në dy shtete anëtare: Belgjikë, Poloni.

5Star+Partia Brexit (ish-EFDD) ka fituar në 1 shtet anëtar: Mbretëria e Bashkuar.

Frans Timmermans, që është rivali kryesor i Weberit për pozitën e shefit të Komisionit Evropian, ka thënë se dëshiron të punojë me partitë progresive për të ndërtuar një program që adreson aspiratat, ëndrrat dhe ndonjëherë frikën e evropianëve tanë të dashur.

Rezultatet e zgjedhjeve në BE nuk e rrezikojnë projektin e zgjerimit

Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të integritimeve evropiane në vend kanë bërë me dije se rezultatet e zgjedhjeve në BE nuk do ta rrezikojnë projektin e zgjerimit të unionit. Ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, ka thënë për gazetën se zgjedhjet për Parlamentin Evropian konfirmuan vetëm pjesërisht pritjet për një forcim të së djathtës ekstreme. "Lajmi i mirë është se partitë proevropiane kanë fituar dhe partitë euroskeptike nuk

kanë fuqi bllokimi në Parlamentin Evropian. Zgjedhjet janë shoqëruar me një rritje të ndjeshme të partive liberale dhe ekologjike. Në Gjermani madje Të Gjellbrit arritën të renditen në vendin e dytë. Në Gjermani fituan kristiandemokratët, në Suedi socialdemokratët, kurse në Francë e djathta ekstreme e Marie Le Pen-it", ka thënë ai, duke shtuar se rritjen e së djathtës ekstreme e kanë ndaluar dy faktorë. "Janë dy faktorë themelorë që ndikuan në shmangien e rritjes më të madhe të së djathtës ekstreme: pjesëmarrja në zgjedhje dhe efekti Strache. Fakti se kësaj radhe në nivel evropian pati një rritje të ndjeshme të pjesëmarrjes në zgjedhje, dëshmon se partitë proevropiane arritën ta mobilizojnë elektoratin kundër rrëshqitjes drejt së djathtës ekstreme. Zbulimi i një skene korruptive proruse të Christian Straches në Austri dekonstruktioi retorikën mashtruese patriotike të partive të ekstremist të djathtë", është shprehur.



icën në Parlamentin Evropian



Ai ka treguar edhe për efektet që këto zgjedhje mund të kenë në raport me rrugën e Kosovës dhe të Shqipërisë drejt BE-së. "Fakti se partitë popullore dhe socialdemokrate kanë dalë grupet më të fuqishme në Parlamentin Evropian, dhe fakti se partitë ekologjike kanë shtuar numrin e ulëseve, është një

garanci se Parlamenti Evropian nuk do të ketë efekte bllokuese për integrim. Megjithatë, të dy qeveritë tona duhet të operojnë me kujdes në rrafshin e politikës evropiane, pasi në disa vende partitë e ekstremit të djathtë janë në pushtet dhe mund të zbatojnë mekanizma bllokues", është shprehur Kiçmari.

Tanja Fajon fiton edhe një mandat

Raportuesja e Kosovës në Parlamentin Evropian, Tanja Fajon, ka fituar edhe një mandat tjetër në Parlamentin Evropian. Tanja Fajon ka marrë shumicën e votave nga Social Demokratët. Për dallim nga Kosova, Shqipëria do të ketë një raportues të ri në Parlamentin Evropian, pasi që raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein, nuk ka arritur të bëhet deputet.

Arba Kokalari, eurodeputetja e parë shqiptare

Arba Kokalari, e cila jeton në Stokholm të Suedisë, është shqiptarja e parë që siguron një vend në Parlamentin Evropian. Politikania e re është pjesë e partisë së moderuar, e cila fitoi 17.6 për qind të votave, duke marrë kështu katër eurodeputetë, mes të cilëve edhe Kokalari. E lindur në Tiranë, në 27 nëntorin e vitit 1986, ajo ka mbajtur postin e sekretares ndërkombëtare të grupimit rinor të partisë në të cilën aderon, e ku ka qenë mjaft aktive. Përmes një mesazhi në profilin e saj në "Facebook", ajo ka falënderuar votuesit e saj. "Moderatorët marrin një mandat të katërt dhe unë kam hyrë në Parlamentin Evropian. Faleminderit për të gjithë ata që kanë luftuar për moderatorët dhe mua!", ka shkruar Kokalari.



Kurse Taulant Kryeziu nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK) ka bërë me dije se nuk pritet që brenda këtij mandati të parlamentit të ri evropian të ketë ndonjë vend anëtar të ri në BE. "Maksimumin çka mund të presim është që Kosova ta fitojë statusin e kandidatit në BE dhe kjo vetëm nëse tregohet më serioze në rrugën e saj drejt reformave evropiane. Serbia do të varet shumë nga pozicioni dhe arritja e marrëveshjes me Kosovën që eventualisht t'i afrohet edhe më shumë rrugës së saj drejt anëtarësimit në BE. Shqipëria dhe Maqedonia mund të hapin nego-

ciatat dhe ta fillojnë negociimin e kapitujve. Pak a shumë ky është një rrumbullakim i përgjithshëm i zgjedhjeve", ka thënë Kryeziu. Parlamenti Evropian përbëhet nga 751 deputetë, të cilët zgjedhën drejtpërdrejt nga votuesit evropianë çdo pesë vjet. Deputetët evropianë përfaqësojnë interesat e qytetarëve të BE-së në 28 vendet anëtare. Kompetencat kryesore të Parlamentit Evropian janë miratimi i ligjeve të propozuara nga Komisioni Evropian, zgjedhja e presidentit të Komisionit Evropian dhe për miratimin e buxhetit të BE-së.

Ministri Ismaili nënshkruan udhëzimin administrativ që ul çmimet e barnave

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka nënshkruar të hënën udhëzimin administrativ për rregullimin e çmimeve të produkteve mjekësore. Me këtë udhëzim përcaktohen dhe rregullohen çmimet e produkteve mjekësore për shitje me shumicë dhe pakicë në sektorin privat nga subjektet e licencuara; të produkteve mjekësore nga Lista e Barnave Esenciale dhe të produkteve mjekësore nga Lista e Barnave të Rimbursueshme nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor. Pas nënshkrimit të udhëzimit administrativ që ul çmimet e barnave në Kosovë, ministri Ismaili ka thënë se kjo ka qenë një kërkesë 20-vjeçare e qytetarëve dhe e farmacistëve. "Çmime të njësuara për barna të njëjta në çdo barnatore dhe barna më të lira në tërë Kosovën, për të realizuar një kërkesë 20-vjeçare të qytetarëve dhe farmacistëve. Jam shumë krenar që sot, për herë të parë në Kosovë, po nënshkruajmë udhëzimin administrativ që rregullon dhe njëson çmimet e barnave", ka thënë ministri Ismaili.

Ai ka shtuar se në mungesë të

këtij dokumenti shteti ka blerë mbi 6 milionë euro më shtrenjtë barna spitalore brenda vitit, ndërsa qytetarët kanë shpenzuar nëpër barnatore rreth 10 milionë euro më shumë për barna në vit. "Ky udhëzim shënon një prej reformave më të mëdha në shëndetësinë e Kosovës. Duke hapur një faqe të re për shtetin dhe qytetarët, ne do të vazhdojmë të jemi në ballë të përgjegjësive tona publike, me qytetarin në qendër të secilës politikë", ka thënë ministri Ismaili.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, këtë të arritur e quajti historike. "Nuk ka gjë më të mirë se t'u gjendesh afër njerëzve në nevojë. Me vetë faktin se ajo çfarë tha ministri, se mbi 10 milionë euro bashkëqytetarët tanë paguajnë për barna, kjo është një e arritur e cila mund të konsiderohet edhe historike, bashkërisht e të gjithëve, jo vetëm e ministrit, por edhe e juve të nderuar farmacistë. Kjo është një dëshmi se mund të bëjmë gjëra të mira kur jemi të vendosur, e kemi qëllimin të pastër dhe dimë si ta bëjmë këtë", ka thënë kryetari Veseli.

Arianit Jakupi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës, në emër të farmacistëve ka falën-



deruar ministrin Ismaili për vizionin dhe guximin që të merret me sfida, të cilat për 20 vjet nuk kanë arritur të adresohen. "Këtë e dëshmon edhe ky draft udhëzim administrativ për çmime që daton nga viti 2003 nën administratën e UNMIK-ut, e i cili asnjëherë nuk e pa dritën e diellit", ka thënë Arianit Jakupi. Përfaqësuesi i Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të

Pacientëve (PRAK), Muhamedali Kodra, ka thënë se kjo është një reformë e mirëfilltë dhe shumë e nevojshme për qytetarët e Kosovës. Duke folur për rëndësinë e tij, ai ka përgëzuar vendosmërinë e ministrit Ismaili për ta hartuar këtë dokument. Përmes këtij udhëzimi administrativ pamundësohet shitja e produkteve me çmime më të larta për barnat që i siguron Ministria e

Shëndetësisë dhe, gjithashtu, shitja në tregun kosovar e barnave me çmime më të larta sesa vlera reale e tyre edhe në tregjet e rajonit. Udhëzimi administrativ do të ndihmojë në njësimin e çmimit të barnave në farmacitë private, me ç'rast për barin e njëjtë qytetarët do të paguajnë çmim të njëjtë në çdo barnatore dhe jo çmime të ndryshme për produkte të njëjta.

Mali i Zi i ofron përkrahje Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 MAJ - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenanti Rrahman Rama, ka pritur të hënën me ceremoni ushtarake shefin e shtabit të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneralbrigade Dragutin Dakiq. Më pas gjenerali Dakiq u prit në takime të ndara nga ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletenanti Rrahman Rama. Ministri Berisha e ka falënderuar gjeneralin Dakiq për angazhimin e Malit të Zi në KFOR dhe në Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në. Më tej, ministri i Mbrojtjes u fokusua në bashkëpunimin rajonal. "Duke pasur parasysh synimin tonë strategjik për anëtarësim në NATO, prioritetet yni është thellimi i bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit që janë anëtare të NATO-s dhe ato që aspirojnë anëtarësim në NATO, duke qenë të bindur se

paqja e përhershme arrihet me anëtarësimin e secilit shtet të rajonit në NATO", ka thënë ministri Berisha.

Gjenerali Dakiq ka falënderuar ministrin Berisha duke ia përcjell mesazhin e ministrit të Mbrojtjes së Malit të Zi për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit. Të dy shefat e ushtrive, gjeneralletenanti Rama dhe gjenerali Dakiq dhe delegacionet e dy forcave zhvilluan një takim të përbashkët, ku u diskutua për marrëdhëniet e mira bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe për nevojën e zgjerimit dhe avancimit të këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.

Në takimin me gazetarë, komandanti i FSK-së dhe shefi i ushtrisë së Malit të Zi, u shprehën se Mali Zi dhe Kosova kanë marrëdhënie të mira në fushën e mbrojtjes dhe se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndër të tjera, gjeneralletenanti Rama ka thënë se synimi i Kosovës është anëtarësimi në



NATO dhe integrimi në Bashkimin Evropian. "Kosova synon të jetë pjesë e strukturave euroatlantike. Mali i Zi deri në anëtarësimin në NATO ka kaluar nëpër të njëjtën rrugë, prandaj çdo këshillë dhe përvijë nga Mali i Zi në këtë fazë të tranzicionit ka rëndësi të madhe për ne", ka thënë gjenerali Rama, duke ofruar

edhe kapacitetet profesionale dhe specialistike të FSK-së si kontribut për bashkëpunimin bilateral dhe fqinjësor. Shefi i ushtrisë së Malit të Zi, Dragutin Dakiq, ka thënë se Mali i Zi promovon idenë e integritit të Ballkanit perëndimor në strukturat euroatlantike dhe se ky është i vetmi qëllim që garanton

paqe dhe stabilitet në këtë rajon. Ai ka theksuar se duke ditur qëllimin strategjik të Kosovës për anëtarësim në NATO, "Mali i Zi është plotësisht i gatshëm që t'ju japë mbështetje juve dhe shteteve të tjera fqinje për realizimin e këtij qëllimi si në nivel bilateral, po ashtu edhe në atë multilateral".

Migrantët që dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre përfitojnë nga programi i IOM-it

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) së bashku me Organizatën Ndërkombëtare për Migracion në Kosovë (IOM) kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim në fushën e menaxhimit të migracionit, me theks të veçantë "Kthimi i asistuar vullnetar në riintegrim" (KAVR). Ky memorandum mirëkuptimi u nënshkrua nga ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa dhe Tajma Kurt, shefe e Misionit të IOM në Kosovë. Me këtë rast, u tha se ky memorandum i bashkëpunimit është shënues i një bashkëpunimi të frytshëm, shumëvjeçar, ndërmjet MPB-së dhe IOM-it dhe partneritetit në fushën e menaxhimit të migracionit. Kthimi i asistuar vullnetar dhe riintegrimi është program i cili promovon dhe përqendrohet në ofrimin e asistencës së migrantëve për t'u kthyer vullnetarisht në vendin e origjinës dhe, si i tillë, paraqet një

ndër iniciativat dhe objektivat kryesore të IOM për përkrahje dhe zhvillim të sistemit të migracionit të fokusuar në mbrojtje të të drejtave të migrantëve dhe kthimin e tyre të dinjitetshëm në vendin e origjinës.

Në kuadër të kësaj iniciative është përfshirë edhe një nen mbi KAVR në Ligjin për të huajt dhe një kapitull në udhëzimin administrativ për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës. Kësaj, migrantët që qëndrojnë në Kosovë dhe dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës tani mund të përfitojnë nga programi i IOM-it që përfshinë këshillimin para nisjes, asistencë shëndetësore, asistencë për pajisje me dokumente relevante të udhëtimit, biletave të aeroplanit, përcjellje gjatë udhëtimit dhe në vendet e transitit, pritje dhe transport deri në vendin e destinacionit, akomodim si dhe përkrahje për riintegrim të qëndrueshëm në vendin e origjinës për rastet ku



kjo është e nevojshme. Kjo iniciativë është marrë në vazhden e shumë iniciativave të tjera të ndërmarra nga zyra e IOM-it në Kosovë në kuadër të projektit "Mbështetja rajonale për menaxhimin sensitiv të migracionit, me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" (projekt i cili zbatohet në

bashkëpunim me Frontex, EASO dhe UNCHR) që, ndër të tjera, vlen të përmendet edhe zgjerimi i bazës ekzistuese të të dhënave për MPB/DSHAM me modul të ri statistikor i cili do të ndihmojë në prodhimin e raporteve periodike në përputhje me standardet e Eurostatit, mbi popullatën dhe migracionin, lejet e qëndrimit

dhe azilin, pajisje dhe trajnime për shfrytëzimin e platformës rajonale online për shfrytëzimin e shërbimeve të përkthimit për gjuhët e rralla të përdorura nga migrantët, përkrahje në hartimin e Strategjisë Nacionale të Migracionit 2019-2023, shtypin e ligjeve dhe materialeve promovuese të rëndësishme.

Mustafa me grupin parlamentar të LDK-së diskuton për rrëzimin e qeverisë

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka zhvilluar të hënën takim me grupin parlamentar të LDK-së. Në takim u bisedua për veprimet e nevo-

jshme për ta proceduar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. U vlerësua se është në interesin e Kosovës që sa më parë vendi të ketë një qeveri normale. Kryetari Mustafa dhe deputetët e

LDK-së vlerësuan se korrupsioni i lartë, papunësia, nepotizmi dhe ikja e njerëzve nga Kosova janë dëshmitë më të mira se vendit i nevojitet qeveri e re e përgjegjshme. "Në ditët në vijim

LDK-ja dhe grupi parlamentar do t'i zhvillojnë takimet e nevojshme me grupet e tjera parlamentare për t'i pajtuar për hapat që do të ndërmerren", është thënë në komunikatën e LDK-së.



Flet për "Epokën e re", Aurora Berisha

Sfidë kryesore në Drenas mbetet ndalimi i ndërtimeve pa leje

Drejtoresha e Inspeksionit në Komunën e Drenasit, Aurora Berisha, ka bërë me dije se ndalimi i ndërtimeve pa leje në këtë komunë mbetet sfida kryesore e këtij sektori. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se inspeksioni në këtë komunë realizon inspektime të rregullta në terren duke parandaluar zhvillimin e ndërtimeve pa leje dhe duke iu kërkuar investitorëve që t'i respektojnë procedurat e aplikimit të lejes. Në këtë intervistë Berisha ka treguar edhe për sfidat që ka hasur në punën e përditshme. Ajo ka vlerësuar se mbështetja politike që kryetari Ramiz Lladrovci i jep asaj dhe gjashtë drejtoreshave të tjera ua ka lehtësuar punën shumë



ushqimit, sidomos gjatë kohës së temperaturave të larta, po ashtu edhe qytetarët duhet të kenë kujdes në higjienën e tyre gjatë ushqimit.

"Epoka e re": Aksionet e kontrolleve të ushqimit, a janë vetëm në raste të veçanta apo i keni të rregullta, si dhe sa inspektorë janë në komunën tuaj që merren me këtë lëmë?

Berisha: Drejtorja e Inspeksionit e Komunës së Drenasit realizon kontrolle të rregullta mujore ndaj të gjitha subjekteve që tregtojnë produkte ushqimore duke inspektuar kushtet e ruajtjes dhe afatin, deklaracionin, prejardhjen dhe temperaturën. Kontrollat e veçanta realizohen gjatë festave të ndryshme kur është paraparë të ketë zbritje dhe kuptohet se produktet mund të jenë të vjetra, pa afat apo jashtë standardeve, dhe qëllimi ynë është t'i evitojmë këto telashe. Mirëpo kontrollat e rregullta mujore na ndihmojnë që gjatë festave mos të hasim në parregullsi të tilla.

"Epoka e re": Cili nga sektorët e inspeksionit komunal përbën telashe më tepër dhe si e menaxhoni?

Berisha: Në Komunën e Drenasit kemi Sektorin e Ambientit, Sanitarisë, Komunikacionit, Tregut dhe Ndërtimit. Sektori i Ndërtimit është më i komplikuari duke pasur parasysh se që nga paslufta kemi të bëjmë me kategori të ndryshme ndërtimi të vrazhdë duke sjell kështu rreth 14 000 ndërtime të egra në komunën tonë. Ne realizojmë inspektime të rregullta në terren duke parandaluar zhvillimin e ndërtimeve pa leje dhe duke u kërkuar investitorëve që t'i respektojnë procedurat e aplikimit të lejes. Kjo ka qenë dhe do të jetë sfida më e madhe e inspeksionit dhe jo vetëm në Komunën e Drenasit. Kjo telashe qëndron edhe në nivelin qendror edhe në komunat e tjera. Deri më tani ne si komunë ia kemi dalë ta ndalojmë ndërtimin në zonën e komasacionit dhe tokave nën ujtitje në gjithë shtrirjen e territorit të komunës sonë. Kjo paraqet tejkallim të një sfide mjaft të madhe sa i përket këtij sektori.

"Epoka e re": Sa e vështirë është që një femër të jetë në krye të Drejtorisë së Inspeksionit?

Berisha: Gjithmonë është sfiduese të jesh në krye të Drejtorisë së Inspeksionit pavarësisht grua apo burrë qoftë udhëheqësi. S'mund të them se paraqet shumë sfida të qenit grua sepse në Komunën e Drenasit kryetari Lladrovci në pushtetin qeverisës ka 60 për qind gra dhe 40 për qind burra, pra prej 12 drejtorive, 7 nga to udhëhiqen nga gratë, duke e thyer barrierën se drejtori duhet të jetë vetëm burrë. Drejtorja e Inspeksionit paraqet shumë sfida duke sjell ligjvënienë në çdo sektor si dhe ndëshkime për mosrespektim të ligjshmërisë. Do të ishte e pamundur të menaxhohet suksesshëm pa përkrahjen politike të kryetarit të komunës. Kryetari Lladrovci që nga marrja e besimit të qytetarëve është zotuar për ligj 100 për qind dhe respektim të tij në çdo procedurë, prandaj kjo përkrahje e lehtëson edhe punën si Drejtoreshë e Inspeksionit, sepse nuk kemi asnjë ndërhyrje politike dhe lëshim.

EPOKA E RE Qendresa RAMA

DRENAS, 27 MAJ -

"Epoka e re": Znj. Berisha, së fundmi dhjetëra qytetarë të Drenasit janë helmuar nga ushqimi. Si është gjendja e pacientëve dhe nga çfarë janë helmuar këta qytetarë?

Berisha: Më 17 maj Komuna e Drenasit, konkretisht Drejtorja e Inspeksionit, pas njoftimit se janë lajmëruar në shërbimin shëndetësor në QKMF-në e Drenasit rreth 14 raste me helmim nga ushqimi, ka marrë masat për verifikim në terren ndaj lokalit ku janë ushqyer këta persona, me ç'rast është njoftuar Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës dhe Stacioni Policor në Drenas për mbylljen e lokalit të dyshimtë dhe janë marrë mostrat ushqimore nga ky lokal. Më pas, me pranimin e analizave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të mostrave ushqimore dhe vërtetësisë se helmimi është shkaktuar nga ushqimi, lokali është mbyllur dhe lënda është përcjell në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Drenas. Gjendja e lokalit do të përcillet nga inspektorati komunal i Drenasit. Gjendja e 26 pacien-

tëve të shtruar në spital është e mirë dhe jashtë rrezikut për jetë në bazë të raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Numri i përgjithshëm i të prekurve me këtë infektim është 88 persona, 26 prej janë trajtuar në QKUK - Klinikën Infektive, të tjerët janë në qendrat e mjekësisë familjare në Drenas. Sipas raportit të IKSHP-së, helmimi ka ardhur nga sosi dhe majoneza shërbyer klientëve të lokalit, ndërsa nga pacientët e hospitalizuar, 16 raste i takojnë gjinisë mashkullore, 11 gjinisë femërore.

"Epoka e re": Pas këtij rasti ka ndërmarrë ndonjë masë shtesë inspektorati komunal i Drenasit ndaj lokaleve afariste apo hoteliere në këtë komunë?

Berisha: Drejtorja e Inspeksionit në kuadër të inspektorëve sanitarë është duke kontrolluar çdo kuzhinë dhe subjekt afarist i cili ofron shërbime ushqimore ndaj qytetarëve dhe duke i pajisur me librezë sanitare. Sepse ofrimi i kushteve standarde sanitare-higjienike është kusht që këto subjekte të jenë funksionale. Gjithashtu, inspektorati i Komunës së Drenasit u bënë thirrje lokaleve afariste hoteliere të kenë kujdes gjatë shërbimit të

ALLED 2 rrit mundësitë e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës



PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, mori pjesë të hënën në konferencën "Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin me kërkesat e tregut të punës - ALLED 2", që financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim.

Qëllimi i këtij projekti është zvogëlimi i varfërisë dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës përmes përmirësimit të punësueshmërisë. Në këtë konferencë morën pjesë edhe

shëfja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ambasadori i Austrisë, Gernot Pfandler, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica dhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj. Ministri Bytyqi me këtë rast ka thënë se Kosova ka një përqindje të lartë të rinisë, e cila konsiderohet burim i potencialeve për punë dhe perspektivë për të ardhmen. Ai ka thënë se përmes projektit ALLED II arsimit i lartë do të ketë më shumë mbështetje në programet e studimeve përmes të cilave do të ketë mundësi më

të mira të zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional. "Përmes projektit ALLED 2 do të mbështetet veprimtaria në arritjen e rezultateve dhe mbështetjen e masave inovative, të parapara sipas planeve IPA 2017. Këtë projekt, i cili do të zgjasë deri në vitin 2022, MASHT-i e konsideron shumë të rëndësishëm, sidomos për uljen e varfërisë në vend, duke rritur pjesëmarrjen e të rinjve në tregun e punës dhe duke rritur punësimin e shoqërisë", ka thënë Bytyqi.

Pse duhet të jenë të ardhurat deri në 300 euro në muaj?



Ramiz KELMENDI

Të ardhurat minimale tm1 prej 130 eurosh dhe të ardhurat minimale tm2 prej 170 eurosh do t'i ilustrojë për vlerën e tatimeve dhe kontributeve që paguhen për këto të ardhura.

1). Paga 170 euro kontributi pensional 8.50 euro, tatimi në pagë 3.26 euro, llogaria 170,00-8,50-3,26 = 158.24 euro/muaj, fondi pensional 17,00 euro.

2). Paga 300,00 euro kontributi pensional 15,00 euro/muaj, tatimi në pagë 9,60 euro llogaria 300,00-15,00-9,60 = 275,40 euro.

Nëse këto i krahasojmë edhe njëra edhe tjetra nuk mjaftojnë për të mbuluar shportën e konsumit mujor, por sa do ta mbulojnë edhe koston mujore të shëndetit dhe shpenzimeve tjera jomjaftueshëm, por del se më mirë me pagë 300,00 euro në muaj.

Meqenëse këto paga janë

ndërlidhur me pagesën e veteranëve të luftës atëherë duhet të zgjidhet ky ngërç duke bërë një shtesë ligjore që paga minimale të jetë e llogaritur në nivel të orës së punës, sepse mundet i punësuar i të mos ketë orar të plotë prej 160 orëve në muaj, e të detyrohet punëdhënësi të paguaj pagën minimale. Nga llogaria del se ora bruto minimale të jetë 1,875 euro.

Pse jam për rritjen e pagesës minimale?

Së pari suporton ngritjet, përafrimin e pagave të institucioneve, së paku ngritë moralin e të punësuarit, ngritë obligimin për shtimin e efikasitetit në punë, dashurinë ndaj punës dhe mund të ndikojë në frenimin e eksodit të të punësuarve.

Paga e rritur minimale nuk dëmton punëdhënësit nëse shtohet së paku efikasiteti në punë, ndihmon në thirrjen e investitorëve të huaj, sepse niveli i pagesës ka përcaktuar tek investitorët vlerën intelektuale të punëtorëve dhe efikasitetin e tyre në punë. Nga eksperiencia si investitorë të punësuarit kanë marrë pagë mbi 20 për qind nga pagat e konkurrencës por edhe kjo

pagë është shumëfish më e vogël se në shtetet e tyre.

Të gjitha këto që e përcjellin vendin tonë me këso pagesash që në shumicën e rasteve janë shfrytëzuar nga punëdhënësit për t'ju shmangur tatimeve dhe pagesë në fondin pensional duke përdorur metodën e pagesave të dyfishta.

Një pjesë e pagesës në llogari me vlerën 170 euro dhe pjesa tjetër në dorë e patatimuar. Por i punësuar i me vetëdije apo i detyruar ka zgjedhur këtë formë si një e keqe më e vogël. Qytetarët dhe të punësuarit duke e parë se pagat nuk kanë trend të rritjes, duke e parë se investitorët nuk po duken askund, duke e parë se punësimi në të gjithë sektorët nuk po bëhet nga profesionalizmi apo aftësia por nga militantizmi politik dhe dëgjueshmëria apo familjarizimi, po del se kjo formë po i detyron të rinjtë e Kosovës ta braktisin shtetin për një vend pune me të ardhura dinjitoze dhe për të siguruar të ardhmen e familjes. Pra, kjo po ndodh duke parë në vazhdimësi premtime për punësim mijëra dhe qindra mijëra që nuk po realizohen.

Ne dëgjojmë këshillat politike se në migrim është vështirë të

punosh, pra duke besuar se këtu punon pak e paguhesh më pak, kjo nuk është vlerë për të parandaluar eksodin, por eksodi ndalohet duke vepruar me kujdes për të hequr të gjitha barrierat që pengojnë zhvillimin ekonomik nga të brendshmit dhe të jashtmit. Kam deklaruar cekur shumë herë më parë se 85 për qind e zhvillimit ekonomik në ekonomitë e vogla dhe të mesme dhe një pjesë e investitorët vendorë, dhe vetëm 15 për qind e bëjnë investitorët e jashtëm dhe atë me bashkëkorrupsion. Nuk duhet menduar se Kosovën nuk mund ta zhvillojnë vendorët por besojnë në vete që po udhëheqin mirë shtetin, e besimi për vete dhe jo për të tjerët dëmton shumë, edhe pse të dyja palët jemi kosovarë.

Ne dëgjojmë se ka dalë ky numër, të tjerët thonë jo aq, por edhe ata do të na sjellin para si diasporë! Kjo mund të tingëllojë mirë, por ata sjellin për vete në kohën kur është sezoni 40 ditësh veror dhe për festa fetare disaditore, ndërsa çka ndodhur me konsumin ditor dhe të ekonomive që punësojnë punëtorë.

Shembull nëse dalin 200 000 qytetarë ata kanë qenë konsumatorë të bukës, vajit lëngjeve, birrës, kafes, ushqimit familjarë dhe hotelierë..., çka ndodh me mësuesit, arsimtarët, energjinë elektrike, institucionet! Kush do t'i konsumojë ato produkte gjatë tërë vitit? Kush do t'i mësojë nëse nuk janë? Kush do t'i shërbejë në institucione ata që nuk janë?, pra ata kanë konsumuar 200 000 bukë në ditë!

Sa furra buke do të mbyllen nga mungesa e konsumit, kafene etj. Andaj, nisur nga këto fakte del se kjo krijon efektin zinxhiror të zvogëlimit të punësuarve ekzistues dhe efektin e eksodit tjetër.

Mund të konkludoj se qasja ndaj këtij fenomeni të eksodit nuk është e mjaftueshme, nuk mjafton trajtimi për zhvillimin ekonomik dhe trajtimi i investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm, apo mund të konkludojmë se efekti i pasigurisë politike të investitorëve po shkakton pasiguri ekonomike te qytetarët dhe e ardhmja e të gjithëve do të jetë e zymtë.

(Autori është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës)

Vetëvendosje: Mbrojtja e prodhimit vendor është strategji për zhvillimin ekonomik

BESIANË, 27 MAJ (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, së bashku me një grup anëtarësh nga qendra e kësaj lëvizje në Besianë kanë vizituar dy fabrika vendore, "Agnesa tekstil (VAVA)", ku angazhohen 70 punëtorë, shumica gra, si dhe fabrikën e keçapit dhe majonezës "AMG", me 13 punëtorë. Në këto vizita aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje janë njoftuar për së afërmi me punën e këtyre fabrikave, njëkohësisht kanë diskutuar me punëtorët e pronarët rreth alternativës së kësaj lëvizje për mbështetjen dhe forcimin e prodhimit vendor. "Mbrojtja e prodhimit vendor është strategji për zhvillimin ekonomik të Kosovës e për rritjen e punësimit në vend. Prandaj në Alternativën Qeverisëse të Lëvizjes vëmendje kryesore iu kushtohet sipërmarrësve që investojnë në prodhim në vendin tonë", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.



Ministria e Financave dhe Banka Botërore mbajtën tryezën e parë për Instrumentin për Zhvillimin e Politikave

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 MAJ - Në Ministrinë e Financave të hënën është mbajtur tryezë prezantimi dhe diskutimi për Instrumentin për Zhvillimin e Politikave (DPO) me Bankën Botërore, e kryesuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe drejtori i Bankës Botërore në Kosovë, Marco Mantovanelli. Me këtë rast, ministri Hamza ka bërë me dije se kjo tryezë e bashkëorganizuar me Bankën Botërore është e para në këtë format me temën për instrumentin e dizajnuar të Bankës Botërore, i ashtuquajtur si DPO apo Instrument për Zhvillimin e Politikave.

"Ministria e Financave në vazhdim të bashkëpunimit të saj me Bankën Botërore, në harmoni me Kornizën e Partneritetit për Kosovën, të dakorduar nga Banka Botërore me Qeverinë e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2018 jemi dakorduar për dizajnimin e një instrumenti të borxhit, i ashtuquajtur si DPO. Deri më tani në Kosovë kemi pasur dy misione të Bankës Botërore (nëntor 2018 dhe janar 2019) të cilët janë takuar me autoritetet tona dhe kanë punuar bashkërisht për identifikimin e reformave dhe kornizave ligjore për t'u bërë pjesë e dizajnit të instrumentit. Reformat janë formalizuar përmes një matrice e cila në formë të 'aktiviteteve

paraprake' vendos afate për realizimin e tyre dhe përcakton entitetet përgjegjëse për realizimin e tyre. Për më shumë, përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës në muajin prill kemi adaptuar matricën në fjalë duke themeluar kështu sekretariatit për implementimin e matricës", ka thënë Hamza.

Sipas ministrit Hamza, afati për realizimin e matricës është deri në dhjetor të 2019-s, me ç'rast pas kësaj pritet që brenda tre muajve Bordi i Bankës Botërore ta aprovojë instrumentin dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ratifikojë në mënyrë që fondet të disbursohen në buxhetin e Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova po e shfrytëzon një

instrument borxhi nga Banka Botërore për herë të parë i cili nga vendet e tjera rajonale tashmë është shfrytëzuar.

Hamza ka shtuar se ky instrument është i rëndësishëm për Kosovën ngaqë do ta hapë rrugën tutje për instrumente të tjera më komplekse për qasje në tregjet ndërkombëtare financiare për huamarrje. "Në të njëjtën kohë kushtet e financimit të Bankës Botërore na ndihmojnë për zgjatjen e maturitetit të portofolit tonë të borxhit publik dhe strukturën e kompozimit të tij", ka thënë ai.

Ministri Hamza ka theksuar se fokusi kryesor i Ministrisë së Financave në këtë instrument nuk është disbursimi i fondeve,

por avancimi i dizajnit të reformave të identifikuara në programin tonë qeverisës. "Kosova përmes këtij instrumenti ka përfunduar mbështetje teknike nga Banka Botërore e cila tashmë ka filluar mbështetjen e ministrive gjegjëse në dizajnim dhe jo vetëm, të politikave publike, për çka falënderoj Bankën Botërore për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar për ngritjen e kapaciteteve", është shprehur ai.

Hamza ka thënë se në kuadër të matricës aktivitetet janë të distribuara në dy shtylla kryesore: stabilitet makrofiskal, si dhe rritje e potencialit ekonomik përmes përmirësimit të klimës së të bërit biznes.



Dogana kalon 400 milionë euro të hyra për buxhetin e Kosovës

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Dogana po vazhdon të tregojë performancë shumë të mirë në të hyrat e grumbulluar për pjesën e parë të vitit 2019. Që nga themelimi i Doganës e deri tani asnjëherë nuk është arritur të kalohen 400 milionë euro në pjesën e parë të vitit, respektivisht në pesëmujorin e parë. "Dogana ka arritur që deri tani të grumbullojë 412 milionë euro e që, në krahasim me periudhën e vitit të kaluar, por edhe disa vjetëve paraprakë, tregon rritje të theksuar. Në vitin e kaluar në këtë periudhë kishim

të hyra në lartësi prej 383 milionë eurosh, kurse në këtë vit të hyrat kanë arritur të jenë më të larta për rreth 30 milionë euro (412 milionë) apo 7.6 për qind më shumë. Kur merret parasysh ndikimi në të hyra që ka MSA-ja dhe lirimet nga taksat në import për prodhuesit kosovarë për lëndën e parë dhe të gjitha inputet që përdoren në procesin e prodhimit, kjo e arritur e doganës së Kosovës tregon përkushtimin dhe profesionalizimin e lartë", është bërë me dije në komunikatën e Doganës.



Vazhdojnë punimet në rrugët e fshatit Gjonaj në Prizren

PRIZREN, 27 MAJ (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se Drejtoria e Shërbimeve Publike është duke vazhduar punimet me

intensitet të lartë në kuadër të projektit për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në fshatin Gjonaj të kësaj komune. Sipas

Komunës së Prizrenit, projekti në fjalë parashihet të kryhet në disa lagje të fshatit si dhe vendosjen e skajoreve në

këto rrugë, në gjatësi të përgjithshme prej 686 metrave. Përveç kësaj, është paraparë edhe riparimi i rrugëve me asfalt.



Asamblistët e Deçanit kërkojnë nga pushteti qendror të bëjë zgjidhje për pronat rreth Manastirit

DEÇAN, 27 MAJ (ER) - Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur të hënën një mbledhje të jashtëzakonshme në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese rreth kontestit pronësor me Manastirin e Deçanit dhe pasojat për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Asamblistët e kësaj komune u kanë bërë thirrje institucioneve të nivelit qendror që të angazhohen për gjetjen e një zgjidhje të mirë për të dyja palët. Ata kanë thënë se përfaqësuesit e Manastirit të Deçanit dhe institucionet lokale e qendrore duhet të ulen dhe të bisedojnë pasi vendimi i Kushtetueses është kundër zhvillimit ekonomik të Deçanit. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka deklaruar se kontesti rreth pronave përreth Manastirit të Deçanit ka filluar qysh në vitin 1992. "Gjeneza e kësaj problematike fillon në vitin 1992 kur punë-

torët e këtyre ndërmarrjeve ('Apiko' dhe 'Iliria') kanë qenë të larguar nga aty, ku situata ka filluar të përkeqësohet e më pas vazhdon deri në vitin 1997, që merr edhe tokën e bletarisë dhe atë të hotelit, duke ia bashkangjitur Manastirit këto toka me rreth 24 hektarë. Kontesti pronësor fillon pas luftës kur punëtorët nuk kanë mundur të kthehen në punë dhe Gjykata e Qarkut në Deçan në atë kohë merr vendim që këto prona iu takojnë punëtorëve. Por, lënda shkon më tutje, mandej Manastiri e dërgon në Gjykatë Kushtetuese, ku kjo e fundit në 2016-n jep vendim pozitiv, pra këto toka i takojnë Manastirit, e jo komunës", ka thënë Ramosaj. Ai ka shtuar se një vendim i tillë i Gjykatës Kushtetuese është i papranueshëm. Ndërsa asamblisti nga radhët e AAK-së, Rifat Stokaj, ka thënë se pushteti i asaj kohe në formë të dhun-



shme ia ka falë Manastirit të Deçanit 12 hektarë. "Që 20 vjet pas luftës qytetarët e Deçanit diskriminohen dhe u ndalohe zhvillimi në infrastrukturën rrugore", ka thënë ai.

Stokaj ka kërkuar nga Agjencia Katastarale e Kosovës që të mos e cenojë Deçanin dhe ta shqyrtojë vendimin përkitazi me këtë çështje. Në anën tjetër, asamblisti Fatmir Kurmehaj nga LDK-

ja ka theksuar se Manastirin e Deçanit e shohim si zhvillim të qytetit, duke bërë thirrje që prijësit fetarë të bashkëpunojnë me pushtetin lokal për të mirën e qytetarëve.

Një delegacion nga Sanxhaku vizitoi Gjilanin



GJILAN, 27 MAJ (ER) - Një delegacion nga Sanxhaku, i kryesuar nga Sulajemna Uglanin, në të cilin ishin të përfshirë përfaqësues të forumit të gruas, atij të rinisë të Partisë së Aksionit Demokratik, por edhe nga Këshilli Nacional i Boshnjakëve të Sanxhakat, themelues i të cilit është vetë Uglanin, ishin mysafirë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.

Në këtë takim Haziri i ka njoftuar mysafirët nga Sanxhaku për të arriturat e Komunës së Gjilanit, regjionit dhe mbarë Kosovës, me theks të veçantë rolin e komunës që drejton për ngritjen e bashkëpunimit ndërkufitar me komunat e shteteve fqinje. Ndërsa kryetari i

Partisë së Aksionit Demokratik të Sanxhakat, Sulejman Uglanin, e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen, duke e përgëzuar atë për të arriturat e Gjilanit dhe shtetit të Kosovës.

Uglanin e ka njoftuar Hazirin për gjendjen e vështirë në të cilën gjendet rajoni i Sanxhakat të ndarë në mes të Serbisë dhe Malit të Zi dhe për iniciativën më të re që ka dalë nga Këshilli Nacional Boshnjak me të cilën kërkohet statusi special për Sanxhakun, i cili do të ketë kushtetutë, parlament, guvernator dhe gjyqësor. Haziri dhe Uglanin janë pajtuar që në të ardhmen t'i kushtohet vëmendje më e madhe bashkëpunimit institucional të Kosovës me Sanxhakun.

Dorëzohet medikamenti 'Amoxicilin' në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë

KLINË, 27 MAJ (ER) - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë është bërë dorëzimi i medikamentit "Amoxicilin", donacion ky i bërë i mundshëm nëpërmjet bashkëpunimit të suksesshëm dhe të vazhdueshëm në mes të "Action for Mothers and Children" dhe organizatës ndërkombëtare "AmeriCares". Në Klinë u

dorëzua një sasi prej 44 kutive të medikamentit në formë donacioni, sasi kjo e cila do t'i mbulojë nevojat e QKMF-së. "Amoxicillin" është lloj antibiotiku i cili përdoret për trajtimin e një numri të madh të infeksioneve bakteriale. Ky medikament në formë të kapsulave mund të përdoret për infeksione të ndryshme si për fyt, pneu-

moni, infeksionet e lëkurës, infeksionet e traktit urinar dhe shumë lloje të tjera të infeksioneve.

Ardhja e "Amoxicilin"-it në Kosovë është bërë e mundur nga ngjarjet bamirëse të mbajtura në vitin 2018 si 'Let's Dance' në Prishtinë, ngjarja 'Meet Us Halfway' në New York, shba dhe 'Darka e Diasporës' në Zvicër.



Kur 'Burdushi' i cakton menynë ushqimore deputetit të Kuvendit të Kosovës



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Këshilla dietale apo delikte morale: Sipas një "rregulli", te shqiptarët gratë janë të paracaktuara për gatitjen e ushqimeve, sidomos tek ata meshkuj parazitë që përtacinë e tyre, dominimin dhe epërsinë e mbështesin në Kanunin e Lekë Dukagjinit e jo në të drejtat dhe përgjegjësitë e barabarta që zbatohen në botën e qytetëruar. Realisht, nëse i shohim statistikat, në fushat ku femrat do të duhej të kishin dominim të plotë, sidomos në fushën e gastronomisë dhe floktarisë, pra në planin e cilësisë së pakundërshtueshme, çuditërisht emrat e meshkujve janë dominues si në planin e gastronomisë, po ashtu edhe të floktarisë. Te shqiptarët është Renato Mekolli që ka bërë emër në gastronomi, pastaj Antoni Atanasi me restorantet Pjer në ShBA si dhe një tjetër në Danimarkë që për disa vjet mori çmimin e parë në Evropë për cilësinë e gatimit. Mos të flasim pastaj për zinxhirin e restoranteve "Te Nazi" që ka më shumë klientë se KFC apo "Burger King" në Kosovë. Nuk po e zgjas më shumë sepse do të duhej të shkruhej një libër i tërë për këtë temë. Po një komunikim midis deputetit të Kosovës, Milaim Zeka dhe përgjigja aspak diplomatike dhe politike e Basri Peçanit, me nofkën "Burdushi", më shtyri ta trajtoj këtë temë e që u bë best-seller në shtypin rozë. Pastaj, për t'i vënë maje këtij prostitucioni në fushën e komunikimit po përkujdesen një kohë të gjatë një president aktual i Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi dhe një ish-president, ish-kryeministër dhe deputet aktual i Kuvendit të Shqipërisë, z. Sali Berisha.

Ta shohim këtë rastin e parë dhe luftën midis dy "gladiatorëve" me lak në fyt, Milaim Zekës, pa nofkë në mungesë të informatave dhe Basri Peçanit - "Burdushit". Që të dy janë gladiatorë mediaë dhe se në komu-

nikimin e tyre nuk i vënë gjuhës, as pikë e as prese e lëre më shenja të tjera të pikësimit. Natyrisht se Zeka, si një gazetar me përvojë, aq sa ka përvojë "Burdushi" në aplikimin e shërimit alternativ që dikush e quan fall, por se shumica i kanë besuar këtij falli, duke e shpërblyer më shumë se të ishte rektor në Klinikën Majo apo në Spitalin në Kejp Taun, Afrika e Jugut, ku Kristian Bernard e bëri transplantimin e parë të zemrës. Milaim Zeka i ka bërë reklamë, pa asnjë kompensim material "Burdushit", duke e bërë Hashim Thaçin të Republikës së "Burdushit". "Burdushi" e ka kuptuar gabimisht promovimin që ia ka bërë Milaim Zeka për faktin se e ka marrë vetëm nga aspekti negativ. Realisht, sot në Kosovë nëse për dikë shkruani pozitivisht do ta merrni në qafë sepse negativiteti dhe ndryshku e kanë përfshirë shoqërinë kosovare në atë masë dhe është bërë shenjë identifikuese dhe referencë për karrierë politike, biznese dhe, vetëm referenca negative ju vendos në piedestalin e të merituarve, të shquarve dhe të respektuarve. Idealizmi, ndershmëria dhe mençuria sot në Kosovë llogariten si pjesa më përmbajtësore e marrëzisë, për fat të keq. Dhe si element çaktimim më të lehtë të diagnozës! Duhet ta keni parasysh faktin se sa shumë duhet të bëni investime e që të bëheni një politikan i provincës e lëre më të bëheni kryetar apo president i një vendi që ofron aq shumë mundësi dhe nga ju nuk kërkon asnjë përgjegjësi, siç është Republika e Kosovës. Ky angazhim vullnetar i Milaim Zekës në promovimin e Republikës së "Burdushit", pa përmendur poste konkrete, është keqkuptuar rëndë nga Basri Peçani, i cili, në një reagim të redaktuar gjuhësisht nga idoli im, Akademik Zafir Berisha, për mendjen time u ngut shumë dhe i hyri në hak Milaimit. "Burdushi" në reagimin e tij u deklarua se kurrë nuk ka qenë anëtar i ndonjë partie politike, se është apolitik (OJQ shumë fitimprurëse) dhe se nuk pajtohet që Zeka ia përmend Republikën e "Burdushit". Duke bërë përpjekje të distancohet nga politika, në reagimin e tij "Burdushi" e përmend argumentin puro politik, m...n, si përmbajtje, ndërkaq, të ambalazhuar si recetë gastronomike apo pjesë e menysë. Ai, sigurisht në mbrojtje të shëndetit të

Milaim Zekës, i thotë se: "Boll ke hangër m.t deri tash dhe mos ha më m.t në të ardhmen..." duke e këshilluar me çka duhet të merret në të ardhmen! E përshkruan të kaluarën, e konstaton të tashmen dhe rekomandon të ardhmen! Realisht këtë debat e shoh krejtësisht të panevojshëm dhe i cili shumë e dëmton Kosovën; në aspektin politik për shkak të përfshirjes së një politikani të rruar dhe të rrahur në të gjitha betejat politike dhe ushtarake siç është Milaim Zeka dhe, të një personi apolitik dhe joqeveritar, humanist i përmasave globale siç është Basri Peçani - "Burdushi". Këta duhet të ulen dhe burrërisht t'i sqarojnë mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet që dallojnë vetëm në nuanca, ndërsa që qëllimin e kanë të njëjtë apo shumë të përafërt. Për të mirën e njerëzimit, Kosovës dhe mbarë shqiptarisë si dhe diversitetit, kulturor, etnik dhe politik siç na ka mësuar Marti Ahtikari me propozimin e tij.

Hashim Thaçi dhe Sali Berisha: Sali Berisha ishte dhe mbeti politikan i që, pas Ahmet Zogut dhe Enver Hoxhës, më së shumti ishte në pushtet në Shqipëri. Dhe, sipas mendimit tim, e që nuk do të thotë se e kam mirë, është pjesë e treshit që më së shumti e ka dëmtuar Shqipërinë dhe shqiptarinë duke mos e zbatuar Kushtetutën e Shqipërisë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë e që duket se në mënyrë brilante po e bënë Hashim Thaçi, i cili po e kërkon ndihmën e një irredentisti të rruar dhe të dëshmuar, Isa Mustafës. Rrahman Morina nuk është më në mesin e të gjallëve. Sali Berisha ka qenë politikan potent derisa në skenë doli, sipas Saliut, Zografi bis (Edvin Kristaq Rama - ashtu ka dëshirë ta quajë), Baton Stanishiqi (për mua është Baton Haxhiu) dhe argati i Serbisë (Hashim Thaçi), sipas Sali Berishës.

Sali Berisha një kohë të gjatë ka mbetur pa pushtet e që po reflekton në sjelljet që i bënë. Përpjekja për ta ricikluar veten përmes riinkarnimit të Saliut të vdekur politikisht në personalitetin e xerox Saliut, Lul Bashës, nuk po ecën sipas planit; as me dinamikën e dëshiruar e as që po i ka efektet e projektuara dhe të pritura. E

keqja e Sali Berishës qëndron në faktin se në humbjen e potencës politike i ka rënë edhe niveli i testosteronit andaj po i bënë këto reagime. Përfundimisht, mungesa e testosteronit ka ndikuar dhe po ndikon që të gjitha problemet e Shqipërisë, Kosovës dhe mbarë Shqiptarisë, sipas Sali Berishës, burimin e kanë te treshja: Zografi bis, Baton Stanishiqi dhe argati i Serbisë në kohën kur për vete po mendon se e ka ruajtur virgjërinë e ndershmërisë të Shën Mërisë dhe se nuk mund të ngarkohet me asnjë mëkat, qiellor dhe tokësor qoftë ai! Tash, caku i të gjitha sulmeve të Sali Berishës është presidenti i Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zotni Hashim Thaçi, ndaj të cilit nuk po zgjedhë fjalë. Besoj se fjalori që e përdor Sali Berisha është autentik dhe se ai vetë i shkruan këto, pa pasur nevojë për ndihmë nga ndonjë këshilltar. Hashim Thaçi po e rëndon tepër Sali Berishën duke e bërë thujta pjesë aktive të Tigrave të Arkanit e që, në rrethana normale dhe nëse nuk jeni pacient i Skender Boshnjakut, nuk do ta besoni. Edhe Hashim Thaçi, ndonëse me moshë është më i ri se Sali Berisha, e ka një përvojë të gjatë në politikë, thujta se po i mbushë 30 vjet të aktivitetit politik, para edhe pas përfundimit të luftës. Është i rryer dhe shumë dinak, hakmarrës i pashpresë i ambalazhuar me një durim prej demokraci dhe stoiku. Çdokush që e njeh Hashim Thaçin, qoftë nëse e ka takuar (kush e ka pasur një fat të tillë) apo edhe vetëm e ka parë përmes medieve, e ka të qartë se një njeri me aq ndjeshmëri, kulturë prej eruditi, me një veshje me shumë delikatesë, nuk është në gjendje të përdorë atë fjalor. Njeri për të cilin janë shkruar libra me vlerë historike, bibliografike, politike, etike dhe që janë promovuar në qendrat më të mëdha kulturore të botës nga njohës të jashtëzakonshëm, asnjëherë nuk do ta përdorë një fjalor të tillë. Njeriu që bartë kollare Hermes, që ka shije për verërat e Shampanjës, të prodhuara nga priftërinjtë francezë dhe që kallamarin e ka ushqimin kryesor në menynë impozante, nuk do të shkruante kështu për Berishën, edhe po të ishte e vërtetë e që unë nuk e besoj. Realisht Hashimin po e mashtrojnë disa këshilltarë që i

ka afër dhe që, si puna ime, nuk e dinë çka është kallamari, por se e mbushin barkun me fasule, për të gjeneruar pordhë të pandërprera, si shenjë identifikuese të statusit politik, shoqëror, material dhe moral. Se Hashim Thaçi qenka argat i Serbisë kurrë nuk e kam besuar dhe as që e besoj sa që nuk e besoj se Sali Berisha ka qenë pjesë e Tigrave të Arkanit. Fjalori i Sali Berishës është denoncues, pa fakte, hakmarrës, por se arsyetohet me moshën që e ka dhe, sidomos, me mungesën e testosteronit. Mungesa e testosteronit, përveç impotencës seksuale, prodhon edhe pafuqi intelektuale. Hashimi është djalë i mirë apo, sipas Edit, çun për së mbari, por se këshilltarët e Hashimit po e marrin në qafë duke luajtur koçe me reputacionin dhe besueshmërinë e lartë që e gëzon Hashim Thaçi. Kotilla këshilldhënëse e Hashim Thaçit përbëhet nga trashëgimtarë të Jugosllavisë dhe Serbisë si dhe "patriotë", denoncues të ish të burgosurve politikë që e fituan këtë status falë angazhimeve patriotike sllave të baballarëve dhe majkave të disa këshilltarëve të kotillës këshilldhënëse të Hashimit. Hashim Thaçi dhe Sali Berisha duhet t'i vënë kapak gojës jo për shkak të tyre, por për shkak të higjienës mentale dhe mjedisore. Hashim Thaçit, si një mik, shok dhe vëllam i një njeriu të jashtëzakonshëm, i pajisur me të gjitha vlerat hyjnore, mbitokësore e sidomos nëntokësore siç është puna e Behgjet Pacollit, nuk duhet ta pranojë autorësinë e postimeve kundër Sali Berishës e që ia bëjnë të tjerët. Çdo miqësi ka çmim, prandaj shumë kujdes. Po shihet qartë se Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacolli janë të gatshëm të vdesin për Kosovën, Shqipërinë dhe mbarë shqiptarinë. Së bashku me Oso Kukën e Lazaratit, Edi Ramën dhe analistin farmakologjik, Batonin.

Sali Berisha nuk ka pse të vdesë, moti ka vdekur dhe nuk paraqet rrezik përveç se i bënë disa delikte verbale me të cilat nuk merret ligji, as në Shqipëri e as në Kosovë! Edi Rama ka vdekur klinikisht! Lëreni Hashimin ta bashkojë Luginën e Preshevës me Kosovën, si hap i parë e pastaj, së bashku me Shumadinë ia bashkëngjitem Shqipërisë! Më m.t nuk bëhet! Hajt Behxhet, he "Burdush"!

Trumpi: ShBA-ja do një Iran pa armë bërthamore

UASHINGTON, 27 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, i cili ndodhet për vizitë në Japoni, tha se Uashingtoni nuk dëshiron ndryshimin e regjimit në Iran, por një Iran pa armë bërthamore. "Mendoj se do të bëjmë marrëveshje me Teheranin", tha Trumpi pas bisedimeve me kryeministrin e Japonisë, Shinzo Abe, në Tokio. Marrëdhëniet midis Teheranit dhe Uashingtonit janë përkeqësuar prej ShBA-ja, një vit më parë, është tërhequr nga

një marrëveshje bërthamore midis Iranit dhe gjashtë fuqive botërore. Me këtë marrëveshje, që është arritur në vitin 2015, Irani ka kufizuar programin e tij bërthamor, në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ekonomike ndërkombëtare. Por, prejse ka dalë nga marrëveshja, Uashingtoni ka rivendosur sanksione kundër Iranit, ka përshkallëzuar retorikën e tij dhe ka rritur praninë ushtarake në Lindjen e Mesme, duke shkaktuar shqetësime për një konflikt të

mundshëm ushtarak me Republikën Islamike. "Unë besoj se Irani do të dëshirojë të flasë dhe nëse dëshiron, ne do të dëshirojmë, po ashtu", u tha Trumpi gazetarëve në Tokio. "Unë nuk dua ta lëndoj Iranin. Dua t'i them: Jo armë bërthamore. Kemi mjaft probleme në këtë botë me armët bërthamore. Jo armëve bërthamore për Iranin", tha Trumpi. ShBA-ja dyshon se Irani po punon fshehurazi për krijimin e armës



atomike dhe kërkon negociimin e një marrëveshjeje më të gjerë për kontrollin e armëve. Irani i hedh

poshtë këto akuza dhe deri më tash nuk është shprehur i gatshëm për bisedime.

ShBA-ja shënon Ditën Përkujtimore të të Rënëve

Në Shtetet e Bashkuara të hënën është shënuar Dita Përkujtimore e të Rënëve dhe janë nderuar të gjithë ata që kanë humbur jetën në luftëra. Në mbarë vendin janë zhvilluar parada dhe festime të tjera. Me këtë rast janë mbajtur ceremoni gjatë të cilave janë vendosur kurora me lule të Varrezat Kombëtare të Arlingtonit

UASHINGTON, 27 MAJ - Mijëra motoçikleta kanë vërshuar në Uashington për të demonstruar në paradën e përvitshme të njohur si "Rolling Thunder". Gjëmimi i motorëve bart simbolikën për ta tërhequr vëmendjen për të burgosurit e luftës dhe ata që figurojnë të zhdukur në aksion.

Tradita e përvitshme e Ditës së Përkujtimit synon ta tërheqë vëmendjen e Uashingtonit ndaj më shumë se 83 000 ushtarakëve që ende figurojnë të zhdukur në veprim që nga Lufta e Parë Botërore e deri në luftimet e fundit në Irak. Lista, gjithashtu, përfshin 126 njerëz që besohet se mungojnë nga operacionet që lidhen me Luftën e Ftohtë.

Vërshimi me motoçikleta u mbajt për herë të parë në vitin 1988. Motoçiklistët zakonisht takohen në parkingun e Pentagonit dhe udhëtojnë drejt Uashingtonit nëpër ura të ndryshme mbi lumin Potomac. Por drejtori ekzekutiv i kësaj parade, Artie Muller, tha se ky është viti i fundit që ky udhëtim do të kryhet në Uashington. Ai tha se është i lodhur me

burokracinë e Pentagonit në koordinimin e ngjarjes dhe shtoi se sponsorëve, shitësve dhe të tjerëve nuk u është dhënë qasje në parkingje, edhe pse organizuesit e këtij udhëtimi me

motoçikleta paguajnë tarifa të lehta për leje.

Për shumë njerëz prania e grupit të motoçiklistëve prej dekadash është bërë sinonim i aktiviteteve të Ditës së Përkujtimit në Uashington. Por presidenti Donald Trump thotë se "Rolling Thunder" është gjithmonë i mirëpritur në kryeqytet. "Patriotët e mëdhenj të Rolling Thunder do të vijnë në Uashington DC vitin e ardhshëm dhe shpresojmë se do të vijnë për shumë vite të tjera. Është ku ata duan të jenë dhe ku

duhet të jenë", tha presidenti Trump duke falënderuar për këtë burrat dhe gratë e Pentagonit.

Në një intervistë me "Zërin e Amerikës", Artie Muller tha se grupi Rolling Thunder është i gatshëm të flasë me presidentin dhe shtoi se në fakt synoj që Rolling Thunder të bëhet një udhëtim mbarëkombëtar në Ditën e Përkujtimit.

Artie Muller tha se udhëtimi vjetor në kryeqytetin e vendit po bëhet i mundimshëm për disa anëtarë të Rolling Thunder. "Ne

të gjithë po plakemi dhe nuk mund të shkojmë aq larg", tha ai. Për anëtarët që vijnë nga bregu perëndimor i ShBA-së, është një barrë e rëndë, për shumë nga ne deri në 4 000 km udhëtim me motor deri në kryeqytet".

Shifrat e Pentagonit tregojnë se 83 000 ushtarakë amerikanë mbeten të pagjetur. Shumica e tyre - rreth 73 000 - janë nga Lufta e Dytë Botërore. Deri në 7 700 janë nga Lufta e Koresë dhe më shumë se 1 600 janë nga Lufta e Vietnamit.



Kancelari austriak humb votëbesimin

VIENË, 27 MAJ - Kancelari austriak Sebastian Kurz humbi votëbesimin në parlament. Mocioni i mosbesimit u mbështet nga ligjvënësit e Social-Demokratëve dhe të partisë së ekstremist të djathtë Liria, e cila ka qenë në koalicion me Kurzin, derisa ky i fundit e ka ndërprerë aleancën me të javën e kaluar.

Presidenti i Austrisë, Alexander van der Bellen, duhet të emërojë tani një kancelar për të formuar qeverinë, e cila do të jetë në detyrë deri në zgjedhjet e

ardhshme të përgjithshme, që pritet të mbahen në shtator.

Kriza politike në Austri nisi dhjetë ditë më parë si pasojë e shfaqjes së një videoje që supozohet se tregonte zëvendëskancelarin Heinz-Christian Strache duke i ofruar kontrata një përfitueseje potenciale ruse, në këmbim të donacioneve politike.

Strache, nga Partia Liria, dha dorëheqje nga qeveria më 18 maj. Në video ai shihet duke pushuar në sofa, duke pirë dhe duke biseduar me një grua që pretendon se

është një ruse e pasur, që dëshiron të investojë në Austri.

Gruaja në video ofron për të blerë 50 % të aksioneve në gazetën austriake "Kronen Zeitung" dhe ta ndryshojë qëndrimin e saj editorial, në mbështetje të Partisë Liria. Në këmbim, Strache thotë se mund t'i ofrojë asaj kontrata publike.

Kurz, udhëheqës i Partisë Popullore të Austrisë, është kancelari i parë në historinë e Austrisë së pasluftës që humb votëbesimin.



Justin Bieber paralajmëron këngën e re



Pas vitit 2017 kënga e parë e Justin Bieberit është "I don't care" në bashkëpunim me Ed Sheeran. Mirëpo Bieber ka publikuar në rrjetet sociale një fotografi në studion e vet muzikore bashkë me gruan e tij, Hailey Baldwin. 25-vjeçari

e ka publikuar këtë fotografi bardh e zi në "Instagram", gjersa tregoi se është duke punuar në një projekt të ri me përkrashjen e bashkëshortes, modelueses 22-vjeçare. "Koha për studio", e ka përshkruar Justini imazhin pranë Baldwin.

Jennifer Lopezi fillon përgatitjet fizike për turneun muzikor



Jennifer Lopezi po sfidon moshën me linjat trupore pasi vazhdimisht kujdeset për fizikun. Këtë po e bën edhe para nisjes së turneut muzikor. Gjatë fundjavës ajo i ka publikuar disa imazhe në rrjetet sociale duke

demonstruar përgatitjet intensive për turneun veror i cili do të përbëhet nga 31 koncerte vetëm në Amerikën Veriore. "Duke e bërë siç duhet, para provave. Së shpejti vjen koha e turneut", ka shkruar ajo në "Instagram".



Alban Skenderaj falënderon të gjithë për urimet e martesës

Të dielën që lamë pas çifti i njohur i këngëtarëve Alban Skenderaj dhe Miriam Cani njoftuan gjithë ndjekësit e tyre se tashmë janë burrë e grua. Njoftimi erdhi disa javë pas ditës së shënuar, pasi ata u martuan në fshehtësi në Maldive. Teksa kanë

marrë urime të shumta për martesën, Albani ka zgjedhur të falënderojë me një fotografi fantastike ku shihen duke u puthur në mes të detit. "Faleminderit nga zemra të gjithëve për urimet! Ju duam shumë", ka shkruar Albani në "Instagram".

Future i blen orë të birit në vlerë 30 mijë dollarë



Reperi i njohur, Future, e ka quajtur edhe djalin e vet me emrin e njëjtë si të tij, Future. Javën e kaluar vogëlushi Future ka mbushur gjashtë vjet, kështu reperi si dhuratë i bleu një orë të markës "Rolex". Kjo orë që vogëlushi e bartë, sipas GQ, kushton rreth 30 mijë dollarë.

E jashtëzakonshme

Kina prezanton trenin me shpejtësi prej 600 kilometrash në orë



Kina ka prezantuar një tren që mund të arrijë shpejtësi prej 600 kilometrash në orë. Ky tren duhet të nisë në vitin 2020 dhe do ta realizojë udhëtimin testues prej pesë kilometrash. Treni në fjalë, nëse vihet në funksion, duhet ta

plotësojë boshllëkun mes trenave që shkojnë në 350-400 kilometra në orë dhe avionëve komercialë që fluturojnë me shpejtësi prej 800 kilometrash në orë.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: I dashur, dua të të them diçka, por më premtë se nuk do t'i tregosh askujt.
Burri: Patjetër, e dashur.
Gruaja: Më duhen 3 000 euro.
Burri: Pa gajle rri, se nuk do ta dëgjoj dikush tjetër nga unë këtë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

“DUMBO” 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min



Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton

Ne ora 16:00 dhe 19:00 “AVENGERS; Endgame”

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min



Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo

Në ora 20:00

“EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE”

Krim/Mister; 1 ore 48 min



Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger

FOTO E DITES



Vendosen flamujt e ShBA-së në varret e veteranëve të luftës me rastin e Ditës së Përkujtimit në varrezat kombëtare të Los Anxhelosit në Kaliforni. /AFP/

E rrallë

Braktiset hoteli më i madh japonez

Vendet e braktisura gjithmonë kanë një bukuri të pamohueshme. Vende 'fantazmë' që tregojnë histori dhe që rrinë pezull midis rrënojave dhe pluhurit. Hotel 'Royal Hachijo' u përrua në vitin 1963 në Hachijo-jima, një ishull vullkanik i vendosur rreth 300 km nga Tokio. Struktura e madhe, e ndërtuar në stilin barok francez, tani është mbyllur që nga viti 2006 për shkak të rënies së turizmit në zonë. Hoteli, ndër më të



mëdhenjtë në Japoni, tani është braktisur dhe bimësia po e pushton plotësisht.



16.05.2019 “THE HUSTLE”

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Sot do ta tregoni kokëfortësinë tuaj karshi një situatë që mund të zgjidhet shumë shpejt nëse ju ishit pak më tolerant. Do ta penalizoni veten.</p>	 <p>DEMI Përparësi do të ketë sektori i punës dhe i financave për sot. Nëse dikush do t'ju kërkojë borxh do të mendoheni mirë përpara se t'ia jepni.</p>	 <p>BINJAKËT Edhe pse jeni shumë të sigurt për ndjenjat që partneri ushqen ndaj jush, sot do të keni mëdyshje në çaste të caktuara.</p>	 <p>GAFORRJA Sot jeni shumë të ndjeshëm karshi çdo fjale të thënë. Do të mbylleni në vetvete dhe do të keni luhajtje humori të shpeshta përgjatë ditës.</p>	 <p>LUANI Ndiheni mjaft lirshëm sot si në takime pune, po ashtu edhe kur shfaqni emocionet ndaj partnerit. Kjo gjë do t'ju japë shumë optimizëm dhe lumturi të brendshme.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Disa mosmarrëveshje me partnerin do ta bëjnë ditën e sotme më të mërzitshme. Do të mbartni mjaft pakënaqësi edhe në fusha të tjera të jetës.</p>
 <p>PESHORJA Nëse doni të keni mirëkuptim në fushën profesionale duhet të sforcoheni edhe ju për t'ua shtrirë dorën kolegëve me të cilët do t'ju duhet të bashkëpunoni.</p>	 <p>AKREPI Sot ndiheni romantik dhe çdo gjë e lidhni me kujtime të bukura të marrëdhënies suaj në çift. Do të keni një lajm nga një person që nuk e prisni.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot keni shumë gjëra për të bërë dhe për të organizuar. Në rrëmujë e sipër do të harroni detaje që më vonë do t'ju prishin punë.</p>	 <p>BRICJAPI Në familje dhe në lidhjen në çift do të keni probleme për ta menaxhuar marrëdhënien e ditës. Për çdo gjest tuajin do të hasni në kundërshtime.</p>	 <p>UJORI Sot nuk do t'ni keni punët mirë me paratë. Do të shpenzoni edhe për gjëra që nuk i kishit planifikuar dhe do t'ju krijohen disa debite të njëpasnjëshme.</p>	 <p>PESHQIT Në një ambient të ri do t'ju marrin me sy të mirë që ditën e parë. Mundohuni të lini të njëjtën përshtypje edhe në vazhdim.</p>

INTERKOMUNIKIMI NË RELIKTE KOHËSH

(Adem Gashi, "E shkrueme për Kryeshpendin", "Buzuku", Prishtinë, 2018)

Nexhat REXHA

Bota në qenësinë artistike ka dimensionin e pikëtakimit në fuqinë e fjalës dhe të penës artistike. Nëpër këto trajtime kohësh e shtegtimesh nga më të ndryshmet radhitet edhe shkrimtari Adem Gashi, i cili që me veprën e parë poetike "Pa ombrellë" (1982) sikur na rikthen në kërkim të diçkaje që i mungon njeriut tonë. Për të vazhduar edhe me vepra të tjera në fushën e prozës dhe të eseistikes. Për të këmbëngulur në misionin e tij prej letrari, e për të vënë në identifikim të asaj që ai ndien për fjalën e bukur artistike. Në këto hapërimet të mëvetësishme ai ka krijuar përcaktimin e tij autonom në kodifikimin artistik, si kushtëzim e luftë me botën e tij shpirtërore. Kjo edhe prej dikton misionin e njeriut artist, për t'i mundur kohët e liga dhe për të shpërndarë në komunikim, rrezatim, shpirtin e trazuar.

Vëllimi poetik "E shkrueme për Kryeshpendin" specifikon në mënyrën e shkrimit gjuhësor, duke shkrirë fenomenin autentik të fjalës shqipe nëpër të cilën kanë skalitur mendjet e ndritura në kohët e dashurisë e dhembjeve të gjata. Në këtë kontekst kohësh e reliktesh burimore kanë shtrirjen e fjalës edhe madrigalet poetike të Adem Gashit. Poezia e këtij vëllimi të orienton në tendencën e përcaktimit në shenjtërinë e Kryeshpendit, në nxitje e motivim për ta ndërtuar tërësinë poetike, si gjallim e komunikim, për t'i ringjallur të bëmat e njeriut nëpër kohë. Njëkohësisht, shpalosjet vijnë edhe si kërkim e kompleksitet për t'i saktësuar lëngimet e tramumatizmet nëpër rrjedhat e rrugëtimit të fatit njerëzor nga trysnitë mbizotëruese të qenies sonë.

Poeti vë në funksion fjalën në poezinë që i paraprin librit "vizatimi i shqiponjës", në të artikulon botën shpirtërore si mekanizëm funksional për ta thënë lirshëm fjalën dhe meditimin pa ndikim të faktorit ndërmjetësues. Në këtë shqipëtim të dashurisë brenda shpirtit poetik, kërkimi dhe endja e shqiponjës të jep parafytyrimin e asaj që mungon apo pengon në madhësitinë e saj. Libri ka shtrirje të gjerë në komunikim e në arkitekturën burimore të fjalës, me shfaqje e artikulum e në zgjedhje sa më funksionale për ta lartësuar bukurinë poetike në shtjellim të enigmës së dikurshme apo edhe të sotmes.

Në këto shqetësime, Ademi ndërton vargun me strukturë e stilistikë të pasur gjuhësore, e cila si mjet e fuqi ka të përcaktuar pritjen e Kryeshpendit si farkues i pritjeve të gjata dhe i mungesës së dëshiruar nëpër breza. Në poezinë "E shkrueme për Kryeshpendin", vlera estetike arrin në sforcime të kuptueshme, të cilat janë objektiva të pranueshme të autorit, sepse dialektika e jetës ka luajtur rol të pranueshëm për njeriun tonë nëpër kohë e sundime të ndryshme. Hana, si figurë kozmike, ka bashkëjetuar në të gjitha variantet e saj, ajo ka shkëlqimin për bukurinë e vashës, ajo ka melodinë në këngën e dashurisë për kurorëzim të ëndrrave që sodisin natën. Dhe kësaj hane, autori i jep faktorizim nëpër kohë dhe e cilëson atë me vjetërsinë e saj, hana e moçme. Dihet se hënën e kanë kërkuar nëpër labirintet e jetës shumë breza, e kush mund të realizojë këtë dashuri e ëndërr më mirë se Kryeshpendi. Në realitetet kërkimi për fluturim në lartësi e shpreh dëshirën për të parë, e për të ruajtur nga "syn'i keq pa t'pamun", janë elemente mistike që i kanë transmetuar njerëzit tanë në ditë sa të lumtura, po aq edhe në ditë të vështira. Këto përsiatje të autorit vijnë bashkë me koloritin e gjuhës së kuptueshme në përjetimin sa më konkretizues dhe njëkohësisht për ta ruajtur filozofinë e ngjyrimet në kohë.

Pritja si konglomerat e ndjesi

Pritja si element i vazhdueshëm në dëshirat e njeriut i ka edhe zbrazëtitë e veta. Nëpër këto halka të pritjeve për Kryeshpendin, koha ka mjegulluar, ndërkaq ëndrrat janë zbehur gjithnjë. Në këto komponente të zgjedhjes së figurave e ndodhive vijnë vargjet me përjetimin e lotit të drenushës, sepse vetëm ajo di ta derdhë lotin përmallshëm, para ndjekjes e kafshimit të ndjekësit. Zëri i humbur ndër vite shëmbëllen me ndjekjet vrastare në atdheun tonë. Ndjekja e mendimit të lirë ka vrarë shpirtin në kërkim të dashurisë e për të dalë nga kohët e egra. Tjetërsimi i mendimit në shtresat e gjëra vazhdimisht ka kërkuar shtegdalje për t'i mundur ëndrrat, të cilat nuk kanë heshtur kurrë. Prometeu si figurë mitologjike ka edhe haraçin e vet, sepse përmes sjelljes së zjarrit e optimizmit që i ka sjellë njerëzimit, ndëshkimet nuk janë ndaluar ndaj tij dhe

ndaj atyre që komunikuan me Hënën e Diellin. Nëpër këto vorbulla të kohëve, sakrificat, dashuria, fljimi për lirinë e vendit, sikur nuk ekuilibrojnë në faktorizim të arsyeshëm edhe në ditët tona.

Lufta, robëria dhe liria


Pikëpamjet tematike në poezinë e Adem Gashit kanë shtrirje në konstatimet e vrazhda brenda ardhjes së ushtrive okupuese. Në këto trajtime e rrafshe artistike ai ka shtrirë preokupimet e tij në disa fushëveprime. Këto veprime asocojnë me vetë rrjedhat në faktorizimin e huaj dhe atë vendor. Në këtë kontekst e platformë Ernesto Sabato në librin "Njerëzit dhe ingranazhet" thotë: "Që nga Rilindja, shkenca dhe filozofia ishin nisur për ta pushtuar botën objektive. Synonin t'i zbulonin ligjet që qeverisin funksionimin e universit, për t'i vënë në shërbim të njeriut". Pra, përkundër luftërave e robërisë në orientim e saktësim të ruajtjes së moralit, autori të jep shpresë në mbështetje të rizgimit për ta arrirë përtëritjen e idealit në imazhet që forcon në ide të adhurimit për Kryeshpendin. Duke besuar se Kryeshpendi ka fuqinë e forcën e ruajtjes së trashëgimisë, sepse pagjumësia e tij ka bërë që të ruajë në sogjëtim gjenin e tij duke prekur të gjitha proceset ekzistenciale të lindjes dhe rritës së njeriut e të vendit të tij.

Liria si adhurim dhe liria si mbrojtje kanë akumulim në dy pritje: e para me entuziazëm për frymëmarrje, mirëqenie të lirë, e cila është ruajtur në fshehtësi me kujdes e dashuri, kurse pritja e dytë krijon befasi dhe të papritura, ajo zhgënjën në realitetin e shumëpritur. Kur liri krijon zjarrmi brenda shumicës së shtresave shoqërore, atëherë plasaritjet krijojnë huti si në vargjet e mëposhtme:
*me shtatë dryna e kemi mshelun
po s'po dim si me e ndamun
n'sytë e tyne tan mjegull
kish xan vend jermi
e s'kishin si me pamun
se rob i kish lidhun kamb'e duer
njajo
me flo'kt e ballit
kryeshpend me kjen
qe çka domethanë
fq. 35*

Pavarësisht prej këtyre rrjedhave shoqërore në pjesën "hana e re", autori na jep përsosmërinë estetike me elemente të sforcimit e të analogjisë. Artikulimi dhe vargu ka ndërtim konstant në

harmonizim e komponimit brenda tërësisë si në tematikë, po ashtu edhe në ide të konkretizimit. Madrigalet determinojnë simbolikën e kuptimdhënies, e cila shkrihet në tërësinë e saj. Libri ka komponenta lirike, të cilat janë arkivuar e ruajtur në memorien e filozofinë e njeriut nëpër kohë të ndryshme. Gjithnjë në kërkim të pritjes së Kryeshpendit, si prijës dhe udhërrëfyes për njohjen e rrethanave që mund të vijnë, ai qëndron besnikërisht në kërkim të lirisë. Poezia e këtij vëllimi ka rrjedhshmërinë në konfiguracion të pasur tematik, gjuhësor e filozofik si dhe ofron në begatimin e përdorimit e fjalëve të zgjedhura, të cilat të japin dykuptimësinë e tyre në bashkëruajtje në urtësinë gojore. Ato krijojnë metaforën edhe të kësaj kohe në fuqizim të natyrshëm artistik. Adem Gashi në fokusim të tërësisë poetike të këtij vëllimi ka zgjedhur fjalën e variantin e gegnishtes, me motivacion se poezia konkretizon arsyeshëm ruajtjen e shpirtit burimor të fjalës shqipe, përkundër veprave të tjera të Adem Gashit që komunikojnë në variantin e standardizuar. Vepra ngërthen në vete tipologji dhe shtrirje të dendur në arealin autokton, ato vijnë lirshëm në parashtrimet e përjetimet e

natyrshme artistike në ide e formulim dhe si filozofi që kanë bartur, ruajtur kohët në bashkëveprim me vizionin e njeriut paraprijës. Për të mos e lënë të këputet fati i tij, e për ta ruajtur gjenin tonë. Akti i fljimit e mbijetesës në librin e Adem Gashit ka transmetim nëpër bartjet e mbrojtjet si kabanë përkundër paradokseve të shfrenuara nga hordhitë e njëpasnjëshme në vendin tonë. Vëllimi poetik "E shkrueme për Kryeshpendin", në substancë brenda kopertinave bartë imazhe, ide në motivim të ndërjegjësimit për fjalën dhe veprimin e klasës udhëheqëse në të gjitha trevat tona. Gjuha e përdorur në vepër specifikon dialektin rrezatues si dëshmi e pasuri të një kohe, që është ruajtur në përvojën dhe fjalën e gjallë për të cilën besojmë se e ka efektin e natyrshëm në rinjohje e plotësim të fjalorit gjuhësor të shqipes. Në realitet "E shkrueme për Kryeshpendin" është manifestim e preokupim i autorit që në vete karakterizon përkatësinë poetike të Adem Gashit, si refleksion që ndërlihd e specifikon fjalën artistike në begatimin e veprës letrare, si dhe me arritshmërinë e korrespondimit në specifikim më të avancuar në rrjedhën e letrave shqipe.



EUROGLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Prekazi: Për Kosovën japim maksimumin

Përzgjedhësi i U21-shave, Rafet Prekazi, nuk ka treguar se cilin rezultat e synon Kosova në dy ndeshjet e qershorit, por ka konfirmuar se motoja mbetet e njëjtë që çdo lojtar duhet ta japë maksimumin për fanellën e "Dardanëve". "Çdo lojtar që paraqitet për Kosovën do ta japë maksimumin. Kjo ka qenë motoja e gjeneratës së kaluar dhe kështu do të jetë edhe kësaj radhe", ka thënë Prekazi



përket komponimit të ekipit, por kjo është puna e trajnerit", ka thënë Prekazi, i cili ka refuzuar të japë ndonjë parashikim për dy ndeshjet e qershorit, kurse ka thënë se synim i tij është komponimi i ekipit. "Nuk jam prej trajnerëve që jap deklarata për

rezultate para ndeshjeve. Objektivi është komponimi i ekipit. Sidoqoftë, ne duhet ta shohim realitetin. Si shtet i ri ndoshta në letër të gjithë mund të jenë para neve, por fusha është diçka tjetër. Kam besim që këta djem do ta japin 200

LISTA E LOJTARËVE

Florjan Smakiqi, Flamur Gashi, Ardit Nika, Ardit Miftari, Leonat Vitija, Kreshnik Hajrizi, Leart Sadiu, Lirim Kastrati, Arbenit Xhemajli, Lirim Meha, Besfort Kolgeci, Fuad Rahimi, Roni Gashi, Kreshnik Krasniqi, Donat Hasanaj, Eris Abedini, Ismet Lushtaku, Gentrit Limani, Blend Baftiu, Lirim Kastrati, Alfred Ajdëreviq, Ardit Gashi, Arbnor Muja, Jetmir Topalli, Mirlind Daku.

përqindëshin e tyre. Jam i bindur se asnjë kundërshtar nuk do të na nënçmojë sepse kemi talente dhe individualist shumë të mirë, por mbetet të shihet se sa do të arrijmë ta komponojmë ekipin për këtë kohë kaq të shkurtër. Por, besoj se bashkërisht mund të shkojmë shkallë-shkallë më lart", ka shtuar Prekazi.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 MAJ - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në futboll do t'i zhvillojë dy ndeshje në muajin qershor. Fillimisht "Dardanët" e rinj i shkojnë më 6 qershor Andorrës, kurse pesë ditë më vonë e presin në "Adem Jashari" Turqinë. Trajneri Rafet Prekazi ka ftuar 25 futbollistë për këto dy ndeshje, kurse risi janë Lirim Kastrati që ishte pjesë e Përfaqësueses A dhe Alfred

Ajdëreviq i cili në të kaluarën ka luajtur për Suedinë dhe Shqipërinë. "Në listën për dy ndeshjet e ardhshme kemi gjashtë lojtarë të vitit 2000, derisa dihet se në këto kualifikime kanë të drejtë loje futbollistët e lindur në vitet '98 dhe '99. Ne presim që edhe kjo gjeneratë të japë më të mirën nga vetja. Çdo lojtar që paraqitet për Kosovën do ta japë maksimumin. Kjo ka qenë motoja e gjeneratës së kaluar dhe kështu do të jetë edhe kësaj radhe. Do të kemi telashe sa i

Shënohet Dita Olimpikë, kryeministri Haradinaj vrapoi me fëmijët e pavarësisë

PRISHTINË, 27 MAJ - 25 komuna kanë shënuar të premtën edicionin e tetë të Ditës Olimpikë 2019, në të cilën kanë marrë pjesë rreth 15 mijë fëmijë të lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës. Fëmijët vrapuan në sheshet e komunave të Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt, Mitrovicës, Gjakovës, Vushtrrisë, Podujevës, Skenderajt, Suharekës, Drenasit, Vushtrrisë, Dragashit, Obiliqit, Kaçanikut, Deçanit, Fushë-Kosovës, Rahovecit, Shtimes, Klinës, Vitisë, Istogut, Kamenicës, Junikut dhe Hani i Elezit, kurse Malisheva e organizoi në stadium. Aktiviteti kryesor u mbajt në Prishtinë, ku mori pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili, pasi përshëndeti



fëmijët, vrapoi bashkë me ta, ndërsa ministri për Kulturë, Rini e Sport, Kujtim Gashi, mori pjesë në hapjen e Ditës Olimpikë në Ferizaj. "Nuk ka kënaqësi më të madhe sesa të fillosh javën në mesin e fëmijëve. Sot iu bashkova

moshave të vogla në fillimin e maratonës në kuadër të Olimpiadës së Fëmijëve. Fëmijët tanë të shkëlqyeshëm janë shembëlltura më kuptimplote e të ardhmes sonë prosperuese. Detyra jonë e përditshme është që

të punojmë bashkërisht që t'u sigurohen kushtet për t'i realizuar ëndrrat e tyre", ka thënë kryeministri Haradinaj. Dita Olimpikë u shënuar në kuadër të përvjetorit të 27 të themelimit (27 maj 1992) të Komitetit Olimpik të Kosovës. Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, përgëzoi fëmijët për pjesëmarrjen masive nga viti në vit. "Ju fëmijët e Prishtinës në vitin 2012 keni qenë katërvjeçarë kur filluat për herë të parë dhe sot janë rreth 15 000 fëmijë të cilët kanë vrapuar në tërë Kosovën. Urime për të gjithë!", ka thënë Hasani. Drejtori i Departamentit të Sportit në MKRS, Ibër Alaj, i cili përgëzoi Komitetin Olimpik për një organizim të tillë, iu drejtua fëmijëve

me mesazhin për të qenë aktivë në sport. Në emër të Komunitetit të Prishtinës, drejtori i Sportit, Fitim Rexha, iu drejtua fëmijëve: "Ju jeni rritur e pavarësisë dhe me juve po rritet Pavarësia e Kosovës çdo vit". I pranishëm ishte edhe koloneli i Ushtrisë së Kosovës, Afrim Veseli, i cili përcolli përshëndetjet e komandantit Rahman Rama dhe të ushtarëve të Kosovës. Në kategorinë e meshkujve (Prishtinë) vendi i parë i takoi Rin Ahmetit, i dyti Flamur Bulliqit, ndërsa i treti përfundoi Erion Beha, ndërsa te femrat vendin e parë e zuri Medina Fejza, e ndjekur nga Erisa Avdullahu dhe Medina Bilalli. Të gjithë fëmijët në të gjitha komunat morën fanella, medalje për pjesëmarrje për tri vendet e para.

Zekaj: Jam krenar që kam zgjedhur Kosovën

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Futbollisti i skuadrës Lille, Arton Zekaj, është pajisur me pasaportë të Kosovës dhe do të jetë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U21 në futboll. "U jemi mirënjohës të gjithë atyre që kanë punuar dhe që e kanë ngritur në këtë nivel Artonin, por edhe menaxherit Milan Kesiç, i cili na ka përkrahur që ta realizojmë dëshirën që Artoni të luajë për Kosovën. Kjo pa dyshim do t'i ndihmojë të rritet edhe më tutje profesionalisht", ka thënë babai i futbollistit, Din Zekaj. Ndërsa kryetari Agim Ademi i

dëshiroi mirëseardhje Artonit në frolenë 'dardane' dhe e falënderoi atë për vendimin e marrë që ta përfaqësojë Kosovën, duke e realizuar në këtë mënyrë dëshirën e prindërve dhe të familjes së tij të gjerë, por edhe të shumë tifozëve. Ademi ka shtuar se paraqitet e mira të ekipit përfaqësues kanë bërë jehonë kudo dhe Kosova po vlerësohet si storie e suksesit, derisa edhe përkrahja e popullit dhe e institucioneve është maksimale, e kjo ka ndikuar edhe te futbollistët shqiptarë kudo që janë që të kenë dëshirë të madhe për ta përfaqë-



suar vendin e originës së tyre. Në fund, presidenti Ademi ia ka dhuru-

ar Arton Zekajt një fanellë të përfaqësueses, të cilën ai do ta veshë për ekipin U21 që nga ndeshjet e muajit shtator, ngaqë për dy ndeshjet e qershorit kundër Andorrës dhe Turqisë nuk do të mund të jetë në shërbim të përzgjedhësit Rafet Prekazi për shkak të lëndimit. Ndërsa vetë futbollisti ndihet krenar për vendimin e marrë që të bëhet pjesë e Përfaqësueses U21. "Për mua është krenari e madhe që e kam zgjedhur Kosovën dhe që do ta veshë këtë fanellë, pasi në këtë mënyrë do t'i bëj krenarë prindërit e mi, familjen time dhe krejt pop-

ullin e Kosovës e, gjithashtu, edhe një njeri të madh që më nuk është në mesin tonë - legjendën, Fadil Vokrri", ka thënë Zekaj, duke shtuar: "I kam shikuar të gjitha ndeshjet e Kosovës dhe jam shumë i lumtur me lojërat dhe rezultatet që i kanë treguar djemtë tanë. Ajo që më pëlqen më shumë te Kosova është fakti që të gjithë luajnë në grup dhe luajnë me zemër, kurse tifozët janë fantastikë. Me një fjalë, krejt populli është përkrah ekipit kombëtar. Pres të kualifikohemi në Evropian, por mbetet të shohim si do t'i shkojnë gjërat".

Wilderi: Dueli ndaj Joshuas, jo këtë vit

WASHINGTON, 27 MAJ - Boksieri amerikan Deontay Wilder pritet të duelojë ndaj Dillian Whytet në gjysmën e dytë të këtij viti. Lajmin e ka konfirmuar vetë Wilderi, i cili ka konfirmuar biseditet me

stafin e Whytes. "Sfida ndaj Dillian Whyte do të zhvillohet. Nëse ai vazhdon të paraqitet kaq mirë, atëherë sfida është e paevitueshme. Por më vjen keq për të, pasi ai do të përfundojë njësoj si Dominic

Breazeale, do të humbasë", u shpreh Wilder. Amerikani jep edhe një sinjal të qartë që dueli i madh mes tij dhe Anthony Joshuas nuk do të zhvillohet këtë vit. "Dueli ndaj Joshuas nuk do të ndod-

hë këtë vit. Boksi është si koha që ndryshon shumë shpejt. Ndoshta nesër them diçka tjetër, nuk i dihet. Mund të ndodhë që gjërat të ndryshojnë tërësisht dhe të duelojmë këtë vit", ka deklaruar Wilderi.



MKRS-ja investon rreth 5 milionë euro në Komunën e Ferizajt

PRISHTINË, 27 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka marrë pjesë në hapjen e Ditës Olimpikë të hënën në Ferizaj. Më pas ministri Gashi ka nënshkruar tetë memorandume bashkëpunimi me Komunën e Ferizajt. Memorandumet e nënshkruara kanë për qëllim mbështetjen financiare të tetë projekteve në këtë komunë. Për projektin "Renovimi i stadiumit të qytetit në Ferizaj", i cili pritet të realizohet gjatë viteve 2019-2021, Ministria ndan mjete financiare në vlerën e 1 milion e 887 mijë e 428 eurove.

Projektin "Pishina gjysmoolimpikë në Ferizaj" Ministria e mbështet me 200 mijë euro dhe pritet të realizohet gjatë vitit 2019. Projektin "Kompleksi i fushave të tenisit" ministria e mbështet me 100 mijë euro, i cili, po ashtu, pritet të realizohet gjatë vitit 2019. Ndërkaq për projektin "Terren sportiv në Dubravë Ferizaj", i cili gjithashtu pritet të realizohet gjatë vitit 2019, Ministria ndan 50 mijë euro. Gjithashtu, mes Ministrisë dhe Komunës ndër tetë memorandume e nënshkruara sot, katër prej tyre u nënshkruan në fushën e trashëgimisë për financimin e këtyre projekteve: Qendra Multifunkionale 200 mijë euro, ndërtesa e Teatrit Adriana Abdullahu, Kisha Katolike, Mulliri i Madh në Ferizaj, Xhamia në Greme dhe Xhamia në Firajë. Të gjitha këto investime kanë vlerën totale rreth 5 milionë euro. Pas nënshkrimit të këtyre memorandumeve, ministri Gashi ka thënë se u nënshkruan një sërë marrëveshjesh për financimin e projekteve shumë të rëndësishme për qytetarët e Ferizajt. "Për herë të parë në Kosovë ne kemi filluar një



cikël të ndërtimit të pishinave gjysmoolimpikë dhe një nga to do të jetë në Komunën e Ferizajt, por ajo që është me rëndësi të theksoj, projekti i vetëm që po fillojmë në Republikën e Kosovës është Qendra Multifunkionale, një objekt që do të ndërtohet në këtë komunë i cili do t'u shërbejë gjeneratave të ndryshme dhe për aktivitete të ndryshme rinore, sportive dhe kulturore", ka thënë Gashi.

Po ashtu, ministri Gashi informoi se pjesë e marrëveshjeve për financim është edhe stadiumi ndihmës dhe renovimi i stadiumit. "Kjo ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e komunës, në të njëjtën kohë përkushtimi ynë për ta avancuar infrastrukturën sportive në Republikën e Kosovës", ka shtuar ministri Gashi. Ndërkaq për financimin e projektit "Terren sportiv në Dubravë Ferizaj", ai tha se po bëhet me qëllim që të gjithë qytetarëve të Ferizajt pa dallim përkatësie etnie t'u krijohet një mundësi dhe infrastrukturë e re sepse dihet që atje jeton komuniteti

RAE. Ai, po ashtu, bëri me dije se investime do të bëhen edhe në fushën e trashëgimisë, përkatësisht në restaurimin e Teatrit të Qytetit, Kishës Katolike, Mullirit të Madh dhe Xhamisë në Greme dhe dha lajmin se do të bëhet edhe funksionalizimi i plotë i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë. Ndërkaq kryetari Aliu shprehu falënderim të veçantë për vizitën e ministrit, kurse ka thënë se me nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit Ferizaj po bëhet shembull i transformimit të përgjithshëm dhe i plotësimit të kërkesave. "Ne kemi folur për projekte të caktuara, madhore dhe të munguara për komunën dhe nga sot po hapim një perspektivë të re të projekteve që kanë të bëjnë me mbulueshmërinë që është pjesë e angazhimeve dhe mbështetjes së MKRS-së", ka thënë kryetari Aliu. Ministri Gashi së bashku me kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, vizituan edhe punimet e Qendrës Multifunkionale në fshatin Greme.

Ramosi, Perezit: Më jep letrat, dua të iki

MADRID, 27 MAJ - Sergio Ramosi e ka ndarë mendjen. Kapiteni ka vendosur të largohet nga Reali dhe të provojë një aventurë të re. 33-vjeçari dëshiron të ndërrojë kontinent dhe të transferohet në Kinë. Një ofertë e pafuzueshme i ka ardhur nga futbollit aziatik dhe qendërmbrojtësi nuk ka ndërmend ta humbasë këtë rast. Sipas raportimeve të programit "Jugones", Ramos është reguar i drejtpërdrejtë me presidentin e Realit. Ai ka marrë pjesë në



një takim me Florentino Perezin, aty ku nuk mungonte edhe vëllai i tij, i cili është agjenti i Sergio, dhe avokati. "Më jep letrat", i është drej-

tuar lideri i ekipit kreut të klubit, ndërsa ky i fundit ka mbetur i befasuar nga kjo kërkesë. "Nuk mund të largohesh. Reali nuk mund ta humbasë kapitenin", është përgjigjur Perezit. Raporti mes të dyve është krisur në mars, pasi Reali u eliminua nga Ajaxi në Ligën e Kampionëve. Perezit shpërtheu në dhomat e zhveshjes. Kritikata pafund për lojtarët u shoqëruan me ngritje zëri dhe ofendime, ndërsa lojtari andaluzian i doli në mbrojtje ekipit dhe shokëve.

SHKURT

Vojvoda lë Mouscronin për Standardin

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, ka ndërruar skuadër, por jo edhe ligën, për faktin se do të luajë sërish në Belgjikë. Vojvoda, i cili mbulon krahn e djathtë të mbrojtjes, ka ndarë rrugët me skuadrën e Mouscronit për ta vazhduar një aventurë të re. Është skuadra e Standard Lieges ajo që ka nënshkruar me mbrojtësin nga Drenica. Mërgim Vojvoda ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me skuadrën e re dhe do ta bartë numrin 27 në fanellë.

Formacioni më i mirë në Evropë

Pas përfundimit të edicionit në pesë ligat më të forta evropiane, Goal ka zgjedhur 11-shen më të mirë të sezonit. Finalisti i Ligës së Kampionëve, Liverpool, dominon në këtë formacion me pesë futbollistë, kurse dy futbollistë i ka Barcelona, aq sa i ka edhe Manchester City. Juventus, Real Madridi, Borussia Dortmund dhe Chelsea përfaqësohen me nga një futbollist. Formacioni: Jan Oblak, Trent Alexander-Arnold, Virgil van Dijk, Gerard Pique, Andy Robertson, Bernardo Silva, Axel Witsel, Eden Hazard, Lionel Messi, Sergio Aguero, Cristiano Ronaldo.

Boatengu, mes Interit dhe Joves


Jerome Boateng nuk bën pjesë në planet e Bayern Munchenit për edicionin e ri, kurse drejtuesit e klubit e kanë këshilluar mbrojtësin gjerman që të gjejë një skuadër të re. "Bild" raporton se për të janë të interesuara dy skuadra italiane, Interi dhe Juventus. 30-vjeçari është pjesë e Bayernit nga viti 2011, kurse më herët ka luajtur për Manchester Cityn dhe Hamburgun dhe Herthan.

De Ligt: Mund të qëndroj tek Ajaxi

Kapiteni i Ajaxit, Matthijs de Ligt, është i shumëkërkuar nga klubet e mëdha, si Juventus, Manchester Unitedi dhe Barcelona, por ai ka paralajmëruar se mund të qëndrojë te skuadra holandeze edhe për edicionin tjetër. "Nuk di asgjë. Gjatë vitit të kaluar kanë thënë dhe shkruar shumë gjëra, por asgjë nuk më bën të çmendem. De Jong e ka marrë vendimin e tij, unë jo, kështu është e vërteta. Shumë skuadra janë interesuar, por është në të mirën time që të vlerësoj një duhet t'i nis përgatitjet e sezonit tjetër me Ajaxin apo diku tjetër. Përderisa kam kontratë këtu, me Ajaxin, mundësia për të qëndruar do të ekzistojë gjithmonë", ka thënë 19-vjeçari De Ligt.

Federeri rikthehet me fitore në 'Roland Garros', eliminohet Venus Williams

Në Paris nisi turneu i dytë "Grand Slam" i vitit në tenis, "Roland Garros". Bie në sy rikthimi pas katër vjetësh i Roger Federerit, me zviceranin që e nisi në mënyrën më të mirë të mundshme këtë turne të rëndësishëm, teksa eliminoi në raundin e parë italianin Lorenzo Sanogo me rezultatin 3-0. Numrit 3 të renditjes botërore iu deshën vetëm 1 orë e 41 minuta për ta mposhtur kundërshtarin e tij, teksa i fitoi setet me rezultatet 6-2, 6-4 dhe 6-4. Për në raundin e dytë u kualifikua edhe talenti grek Stefanos Tsitsipas, që mundi gjermanin Marterer me rezultatin 3-0. Numri 6 i botës ishte superior ndaj rivalit të tij dhe i mbylli setet 6-2, 6-2 dhe 7-6, brenda 1 ore e 48 minutash lojë. Në kampin e femrave bie në sy eliminimi i Venus Williamsit që në raundin e parë. Tenistja amerikane u mund nga tenistja ukrainase Elina Svitolina me rezultatin 2-0. Svitolina ishte superiore ndaj Venus Williamsit duke i fituar setet e sfidës me rezultatin 6-3 dhe 6-3. Me vështirësi u kualifikua për në raundin e dytë Garbine Muguruza, me tenisten spanjolle që mundi Townsend me rezultatin 2-1. Ishte Townsend ajo që fitoi setin e parë 7-5, por Muguruza përbysyi gjithçka, duke fituar dy setet e tjera me rezultatet 6-2 dhe 6-2.

Autor: Gazmend Morina - BENI	SËMUNDJE QË SHKAKTOHET NGA SASIA E MADHE E AZOTIT NË GJAK	FUTBOLLISTI YNË ALTIN	E MBARUAR, E PËRFUNDUAR (krah.)	"MISS ALBANIA 2003" DENISA GEVRIL (shk.)	RENS ISTVUD	ZANORE	VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE (sh.shq.)	EPOKA E RE	RILINDËSI YNË VRETO	ALBIN KURTI	SHKOP I BILARDOS	DILETANT	MUNDIM I MADH, VUAJTJE (sh.pashq.)	ANGOLA	AGJËRIMI (krah.)	QESËNDISËS		
QË KA NJË KUPTIM TJETËR TË FSHEHUR PRAPA								NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE (shq.) KËNGËTARJA BRITANIKE TIKARAM										
VEND ME DRURË E ME SHKURRE TË DENDURA (shq.)						SHKRETËTIRA MË E THATË NË TOKË (KILI) UJË I YNI MINERAL								IRLANDA (shk.) ZANORE				
E DASHURA E POPAIT LARTËSIA E TRUPIT TË NJERIUT (pashq.)					SHTET AZIATIK ABDURRAHMAN NOKSHIQI (Nofka)					LOLAK LUKSOZ KU LUHET BIXHOZI SHKRONJA TË NJËJTA								
				RRUGË QË HAPET NËN TOKË		KËNGËTARJA KANADEZE MORISSET AKTORJA ARVANITASE PAPAS					"TENERIF E" NJË LLOJ PIJE ALKOOLIKE			INDIUM "INTER"				
ZANORE		NDERIMI QË I BËHET MYSAFIRIT (arab.) BESIM NË ZOT (mysl.)								NDALIMI I VETURËS NGA POLICIA KËNGËTARJA NË FOTO 1								
SHTET FEDERAL NË SHBA						"T" në mes të dy "E" BASHKËVEN-DASE E ODISEUT				LUMË NË KOSOVE QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shq.)								
E QËNDRUESHME NDAJ SËMUNDJEVE					SFOND SHKRONJASH NUKLEARE													
EPOKA E RE	FUSHË KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE A NJË LUFTIM (sh.shq.) KORÇA						TREVISO	INTERNSTIO. TEATRE INSTITUTE										
KËSHILLI NACIONAL			SËPATË E VOGËL (sh.shq.)					SHPREHU ME FJALË DRY										
2								QYTETI FRANCEZ I FILMIT KËNGË DJEPI										
			OLIVER KAHN															
			QENGJI I BUTË													PËRGËZIMET		
			I SHOSHITA													ZANORE BANORET E NJË QYTET TONË		
			SHTET NË AFRIKË (pashq.)									KNADAHARI, RUANDA PËRKRAHJE PËR NJË EKIP			ZURICH INTERNATIONAL TROVBER	I KËTJË ÇASTI, I KËSAJ KOHE	AKTORI AMERIKAN DEJMON (shq.)	ELIZABETH TAYLOR
	ELBASAN					ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE (sh.shq.) KUNDREJT NGRIHU												
	NJËZËSHMËRIA GRUP NJERËZISH TË LIDHUR NGA INTERESA VETJAKE TË NJËJTA (sh.shq.)																	
EPOKA E RE	ELEMENT KIMIK (shq.)	DASHUROR	ISH FUTBOLLISTI I SHQUAR JAPONEZ HIETOSHI (Parma, Roma)	NËNË (turq.)	VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)											BASHKËTING-ËLLORE DJALLI, LANETI		
PILOTI I NDJERË I "Formula 1" AIRTON						LOGICAL UNIT NUMBER DUSELDORF			KRAHINË NË SHQIPËRI PAMELA ANDERSON			FILLOVA DRITA						
KËNGËTARJA NË FOTO 2 LIBOHOVA							ANTON PASHKU SHKENCËTARI NJUTON			STRUGA FIGURË SHAHU			KAM DIJENI PËR DIÇKA KËNGËTARJA E FAMSHME ELLIOT			ABEDIN REXHA KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)		
GRUA E MOSHUAR, PLAKË						NORA ISTREFI BASHKËTING-ËLLORE			EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së GRIMOVA (krah.)			VEGËL BUJQËSORE				... TAK		
ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË			FUTBOLLISTI ARGJENTINAS LIONEL ANNA RUSO						BABAI ALESANDRO NESTA			NËNAT ESTONIA, SUEIDIA						
VEPËR E JOSIP RELËS						AQ SA DUHET, AS MË SHUMË E AS MË PAK (turq.) ISLANDA						LUMË NË SHQIPËRI (shq.) BRAGA						
FLUTURUESI I PARË (mit)							NJË LLOJ BIME NARKOTIKE									AKTORI I FAMSHËM LACHEY (shqip.)		



Lexus të nderuar, për vërejtje dhe sugjerime mund të shkruani në: fjalékryqi_beni@yahoo.com & gazmend78@hotmail.com

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: ALEGORIK, JATAGANI, ZABELI, ATAKAMA, IR, OLIVA, OMAN, KAZINO, SHTAT, ALANIS, TE, IN, E, TIBARI, STOPIMI, MISURU, ETE, ERENK, IMUNE, ITALIK, ARENAT, ITI, KN, LATAT, FOL, OK, KANA, MANARIU, I SITA, U, KENI, KR, E, ANALIZIMET, UNANIMITETI, KLARINETAT, P, SEMA, LUN, MAT, NISA, ERANDA, AP, S, DI, AR, LOKE, NI, ADEM, SHAT, ETA, MESI, ATI, EMAT, NITA, TAMAM, SEMANI, IKARI, KANABIS, NIK.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike,,Ibër-Lepenc" S.H.A. – Prishtinë, publikon këtë:

KONKURS

1. Menaxher i Njësish Afariste "Ujitja" (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si në vijim

- Menaxhon personelin e Departamentit për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujitjes;
- Në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive punuese dhe inxhinierin kryesor harton planin vjetor dhe planin afatgjatë të punës së Departamentit për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujitjes;
- Planifikon afarizmin dhe buxhetin e njësish afariste të ujitjes;
- Ndërmerr masa për përparimin e procesit të punës dhe metodave të punës;
- Drejton punëtorët e N.J.A të ujitjes për kryerjen e të gjitha detyrave dhe punëve të N.J.A.;
- Koordinon punën e njësive punuese brenda përbrenda dhe të pjesëve tjera të Ndërmarrjes;
- Kujdeset për zbatimin e planeve vjetore dhe detyrave të përditshme në N.J.A.;
- Propozon rindarjen e orarit të punës, ose punë më gjat se orari i rregullt të punës;
- Kryen dhe punë tjera sipas urdhërimit të punëdhënësit të Ndërmarrjes;
- Për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit Teknik dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimt.

Kushtet:

- Diplome Universitare, dega e bujqësisë, (Preferohet Master në fushën e Bujqësisë);
- Ai/Ajo më së paku duhet të kenë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, dhe aftësi ndër njerëzore;
- Ai/Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moralë të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Shkathësitë themelore kompjuterike janë të nevojshme (Windows OS, Microsoft Office);
- Kandidati duhet të zotërojë mirë së paku një nga gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Njohja e gjuhëve tjera si, angleze dhe gjuhëve tjera botërore është përparësi.
- Përvoja e punës së paku 3 (tri) vite në pozita udhëheqëse dhe detyrat e punës të cilat i përgjigjen natyrës së punës të kësaj Ndërmarrje.

2. Zyrtar i lartë i prokurimit(1)

Detyrat dhe përgjegjësitë do të jenë si vijim:

- Organizon punën e komisionit të hapjes dhe vlerësimit;
- Propozon dhe përgatit vendimet e komisioneve;
- Mbanë evidenca dhe raporte për numrin e prokurimeve të realizuara në Ndërmarrje;
- Bën pranimin e kërkesave për prokurime;
- Në bazë të kërkesave imicon procedurat e prokurimit, varësisht nga vlera e tenderit bën përgatitjen e dokumenteve të tenderit (kërkesa për kuotime, vlera minimale (V.M. realizon komplet dhe nënshkruan formularin për vlerat minimale);
- Realizimin e kërkesave dhe nënshkrimin e kontratave (në mungesë të Drejtorit);
- Hapje te ofertave;
- Kontrollimi dhe krahasimin e ofertave;
- Për punën e vet raporton dhe i përgjigjet Drejtorit të Prokurimit;

Marrëdhënia e punës: Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimt.

Kushtet:

- Diplomë Universitare (Fakulteti Ekonomik/Juridik)
- Njohja e programeve kompjuterike

Kërkesës për pozitat e kërkuara t'i bashkëngjitet:

- CV;
- Diplomën;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Dëshmitë për kualifikimet plotësuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hetim;
- Fotokopja e letër njohimit;

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ndërmarrjes www.iber-lepenc.org.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmitë të kërkuara sipas konkursit dorëzohen në Drejtorinë Qëndrore të N.H.,Ibër-Lepenc" – Prishtinë ose përmes postës.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen

Me kandidatën e zgjedhur do të nënshkruhet Kontrata e punës pas sjelljes së certifikatës mjekësore.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Kosova Cumhuriyeti

Republic Of Kosovo



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren-Prizren Belediyesi

Municipality Of Prizren

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

DATË:	
REFERENCË:	Zyrtar
NGA	Drejtoria e Shërbimeve Publike – Prizren
TEMA	Plotësim Shpalljes - "Shërbimi i transportit me mjete bartëse Merimangë"

Plotësim i shpalljes

Duke u bazuar në vitet paraprake, Komuna e Prizrenit ka pasur dy kompani të shërbimit të transportit me mjete bartëse (Merimangë).

Andaj në shpalljen e publikuar të datës 24/05/2019 me titull "Shërbimi i transportit me mjete bartëse (Merimangë), plotësojmë shpalljen duke hapur ftesë për ofertues me të cilën do të përzgjidhen 2(dy) kompani të përgjegjshme.

Kërkesat për dokumente të kërkuara në shpalljen e datës së lartcekur nuk ndryshojnë.

Ju faleminderit në mirëkuptim...

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania " Prominent Network " L.L.C SH.P.K. me seli në Sopi – Suharekë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit 811033795 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillim të procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë-Debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavamo sve klijente da Tvrtka " Prominent Network " L.L.C SH.P.K. sa sedistem u Sopi-Suhareka, donijelo odluku da ugasi biznis po broju registra 811033795. Ujedno imenovao likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju izvestaje o kreditu-duzniku u ovoj kompaniju obavestavaju se u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company " Prominent Network " L.L.C SH.P.K. in Sopi-Suhareka, has come to the decision to quit its business with registry number 811033795. The Company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgages-mortgage accounts in this Company are kindly request to show up within 30 days starting from the day newspaper announcement publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofritit të te Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje
për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Anketues/ Intervistues për Statistikat e PRODCOM-it 2018
Numri i referencës:	ASK-DSE-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Tek njësia për Statistikat e PRODCOM-it në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Një (1) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK- 8

Detyrat dhe përgjegjësitë për Anketues :

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketës, të dhënat mbi qarkullimin e bizneseve) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën e PRODCOM - it 2018.
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e PRODCOM - it 2018
- Të bëjnë identifikimin e të gjitha bizneseve në bazë të mostrës duke bërë anketimin e të gjitha ndërmarrjeve, ekonomive familjare.
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që duhet t'i parashtrajnë personit përgjegjës në njësi raportuese dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën shqipe.
- Të bëjnë raportimin ditor tek mbikëqyrësi.
- Të përfundojnë Anketa brenda afatit.
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar nga bizneset si sekret zyrtar.

Përgatitja shkollorë/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme.
- Të jenë student të fakultetit (ekonomiku përparësi).
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopeve/tabletave)
- Përparësi kane kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit.
- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marre pjesë së paku në një anketë.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi;
- Përvoja e mëparshme në anketat e ngjashme,
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.

Përgatitja shkollorë /përvoja për mbikëqyrës për anketën e PRODCOM - it 2018:

- Aplikantët që konkurrojnë për këtë vend të punës duhet të kenë të kryer fakultetin (ekonomiku përparësi), kandidatët me përgatitje më të lartë shkollorë kanë përparësi;
- Përvoja e mëparshme në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së Anketave në terren, kontrollimin e pyetësorëve të anketave të ngjashme, si dhe të jenë të gatshëm të ju ndihmojnë anketuesve në teren kur ata kanë vështirësi ose kanë nevojë;

- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të jenë të gatshëm të punojnë ndonjëherë me orar të zgjatur ditor përfshirë vikendet;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe te punës ekipore.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.

Përgatitja shkollorë /përvoja për kodifikues për anketën e PRODCOM - it 2018:

- Aplikantët që konkurrojnë për këtë vend të punës duhet të kenë të përfunduar fakultetin (ekonomiku përparësi), kandidatët me përgatitje më të lartë shkollorë kanë përparësi;
- Përvoja e mëparshme në mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së Anketës, kontrollimin e pyetësorëve të anketave të ngjashme, si dhe të jenë të gatshëm të ju ndihmojnë anketuesve kur ata kanë vështirësi ose kanë nevojë;
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të jenë të gatshëm të punojnë ndonjëherë me orar të zgjatur ditor përfshirë vikendet;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe te punës ekipore.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi dhe njohuri në shfrytëzimin dhe përdorimin e Regjistrave dhe klasifikimeve;
- Aftësi kompjuterike, word, excel, internet etj;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web - faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve	5 (pesë)
Numri i kodifikuesve	2 (dy)
Numri i mbikëqyrësve	1 (dy)

	Regjioni	Numri i anketuesve për regjion	Kodiifikues	Mbikëqyrës
1	Gjilani	1		
2	Prizreni	2		
3	Ferizaj	2		
	Gjithscjt	5	2	1

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web. faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr." Zenel Salihu " nr.4, 10000 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, tema e diplomës apo vërtetimi nga viti i fundit i nivelit të shkollimit (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje). Kërkesat c dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat c pakompletuara do të refuzohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët c përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testit me shkrim.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149, 200 31 133 apo 200 31 118 prej orës 08:00 -16: 00.

¹ Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -
Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

**Javni Konkurs o Sporazumu
za Posebne Usluge**

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Anketar/ Ispitivač za Statistiku PRODCOM-a 2018
Referentni broj:	ASK-OES-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Jedinici za Statistiku PRODCOM-a u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge–(SPU)
Trajanje ugovora:	Jedan (1) mesec
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 8

Zadaci i odgovornosti anketara:

- Učestvuje u obukama i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (Osnovnim podacima iz ankete, podacima o poslovnom prometu) i bude spreman da ih primenjuje na terenu na osnovu uputstva PRODCOM-a 2018;
- Prikupi podatke za anketu PRODCOM-a 2018;
- Vršiti identifikaciju svih poslovanja na osnovu uzorka anketiranjem svih preduzeća, domaćinstva;
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koje treba da postavlja odgovornoj osobi u izveštajnoj jedinici i prati sve procedure i objašnjenja opisano u uputstvima;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na Albanskom jeziku;
- Dnevno izveštava svom supervizoru;
- Završi Anketu u propisanom roku;
- Sve dobijene podatke od poslovanja treba da čuva kao službenu tajnu.

Školska sprema /iskustvo

- Da ima najmanje završenu srednju školu;
- Da bude student fakulteta (ekonomski fakultet prednost);
- Iskustvo u upotrebi informacionih tehnologija (laptopa / tablet računara);
- Prioritet imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili koji su učestvovali u najmanje jednoj anketi.

Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Prethodno iskustvo u sličnim istraživanjima;
- Spreman/na za timski rad;
- Veštine i znanje u korišćenju i upotrebi Registara;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.

Školska sprema /iskustvo supervizora za Anketu PRODCOM-a 2018;

- Kandidati koji se prijavljuju za ovaj posao treba da imaju završeni fakultet (ekonomski fakultet je prednost), Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.

- Prethodno iskustvo u praćenju izvođenja anketa na terenu, kontrola upitnika sličnih anketa, kao i da budu spremni da pomažu anketarima na terenu kada imaju poteškoće ili kada ime je to potrebno;
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;
- Veoma dobre komunikacione veštine i veštine timskog rada.

Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Spreman/na za timski rad;
- Veštine i znanje u korišćenju i upotrebi Registara;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Sposobnost prostorne orijentacije(korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;

Školska sprema/iskustvo za kodifikatore ankete PRODCOM-a 2018:

- Kandidati koji se prijavljuju za ovaj posao treba da imaju završeni fakultet (ekonomski fakultet je prednost), prioritet imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.
- Prethodno iskustvo u praćenju izvođenja anketa na terenu, kontrola upitnika sličnih anketa, kao i da budu spremni da pomažu anketarima na terenu kada imaju poteškoće ili kada ime je to potrebno;
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;
- Veoma dobre komunikacione veštine i veštine timskog rada.

Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Spreman/na za timski rad;
- Veštine i znanje u korišćenju i upotrebi Registara i klasifikacija;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Dobre organizacione veštine i spreman/na da ponekad radi prekovremeno, uključujući vikende;

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Gradani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb-stranici ASK-a.

Broj anketara	5 (pet)
Broj kodifikatora	2 (dva)
Broj supervizora	1 (jedan)

	Regioni	Broj anketara po regionu	Kodifikatori	Supervizori
1	Gnjilane	1		
2	Prizren	2		
3	Uroševac	2		
	Ukupno	5	2	1

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikaciju potrebno je priložiti: CV¹, Kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, diplomski rad ili potvrda iz poslednje godine nivoa obrazovanja, (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka *neće* biti prihvaćene

U slučaju velikog broja primljenih prijava, *samo kandidati* koji uđu u *uži izbor* biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće pismeno testirani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038-200 31 149 ili 200 31 118 od 08:00 – 16: 00 časova.

¹ Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/giejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Loging Electronics-Kosova" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810829385.
- ▶ "Sofrabezi" Sh.p.k shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 600793063 dhe numër të regjistrimit: 70836661.
- ▶ Marigona Krasniqi shpallë të pavlefshëm dëftesat e SH.F.M.U "Ibrahim Fehmiu" - Arban/Prizren.
- ▶ Elida Guraziu shpallë të pavlefshëm dëftesat e klasës 6, 7, 8, 9, shkolla fillore "Abdyl Frashëri" Prizren.
- ▶ Alban Nerjovaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit
- ▶ Ryvejda Topojani shpall te pavlefshme dëftesat certifikaten diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Flamur Mazreku shpall te pavlefshme certifikaten shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Mirdona Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat shme "Ymer Prizreni" Prizren
- ▶ Sema Matijani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Drenita Shala shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren
- ▶ Lëshoj lokalën më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales